



safejournalists.net

SHQIPËRIA

Siguria e grave gazetare

Raporti për Shqipërinë

2024

Autor
Blerjana Bino



TABELA E PËRMBAJTJES

I	Hyrje	2	V	Siguria e grave gazetare 2021—2024	24
1.1	Rreth Rrjetit të Gazetarëve të Sigurt	2	5.1	Njoftimet e SJN për sulmet kundër grave gazetare 2021-2024	24
1.2	Arsyetimi për fokusin në trajtimin e sigurisë së grave gazetare	3	5.2	Format e sigurisë së grave gazetare	25
1.3	Objekti dhe struktura e raportit	4			
II	Metodologjia	6	VI	Përvojat dhe perspektivat e grave gazetare	27
III	Siguria e grave gazetare dhe dhuna me bazë gjinore në gazetari – Kuadri ndërkombëtar	9	6.1	Kërcënimet dhe kanosjet e shpeshta në vendin e punës	27
3.1	Ndikimi i dhunës me bazë gjinore tek gratë gazetare dhe te mediat	9	6.2	Ngacmimet online dhe fushatat e shpifjes	29
3.2	Ndërseksionaliteti dhe dobësitë specifike	10	6.3	Ngacmimi seksual si shqetësim i fshehur, por i vazhdueshëm	32
3.3	Angazhimet ndërkombëtare për eliminimin e dhunës me bazë gjinore	11	6.4	Kërcënimet ligjore kundër grave gazetare	33
3.4	Kornizat e Bashkimit Evropian për mbrojtjen e grave gazetare	13	6.5	Presionet e brendshme dhe vete-censura	35
			6.6	Kushtet e punës	37
IV	Kuadri kombëtar në mbrojtje të grave gazetare	14	VII	Përfundime	40
4.1	Garancitë Kushtetuese dhe Parimet e Përgjithshme	14		Konteksti dhe objekti i studimit	40
4.2	Legjislacioni penal dhe boshllëqet e kapaciteteve institucionale për gratë gazetare	15		Përmbledhjeve e gjetjeve kryesore	40
4.3	Mangësitë në trajtimin e dhunës ndaj grave gazetare në hapësirën digjitale	18		Gjithëpërfshirja dhe pabarazitë strukturore	41
4.4	Kuadri strategjik për barazinë gjinore	19		Reagimet institucionale dhe organizative	41
4.5	Ligji kundër diskriminimit	20		Implikimet e gjetjeve në përgjithësi	42
4.6	Të drejtat e punës dhe siguria në vendin e punës	21	VIII	Rekomandime	43
4.7	Ndihma ligjore dhe mbështetja institucionale	22	A.	Rekomandime për autoritetet publike	43
4.8	Legjislacioni për mediat audiovizive	23	B.	Rekomandime për mediat	45
			C.	Rekomandime për shoqatat dhe sindikatën e gazetarëve	45
			D.	Rekomandime për organizatat e shoqërisë civile	46



Hyrje

Në këtë kapitull jepet konteksti, objekti dhe struktura e raportit. Ai fillon duke përshkruar punën e Rrjetit të Gazetarëve të Sigurt (SafeJournalists Network - SJN), një platformë rajonale e mbështetur nga Komisioni Evropian, që përmes hulumtimeve rigoroze dhe të bazuara në të dhëna monitoron lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Që nga viti 2020, nën drejtimin e studiueses Blerjana Bino, SJN ka hartuar disa raporte vjetore për Shqipërinë, duke dokumentuar sfidat madhore për lirinë e medias, ndërkohë që fokus të veçantë në këtë raport i kushtohet sigurisë së grave gazetare. Aty shtjellohet arsyeja për këtë fokus specifik gjinor, duke nxjerrë në pah kërcënimet serioze dhe shpesh të nën-raportuara me të cilat përballen gratë në media, përfshirë këtu ngacmimin digjital, kërcënimet me padi gjyqësore dhe dhunën me bazë gjinore - si në internet ashtu edhe në jetën reale. Duke u mbështetur në instrumente kërkimore cilësore dhe sasore të hartuara nga SJN, në këtë raport analizohen shkeljet ndaj grave gazetare në Shqipëri gjatë viteve 2021 dhe 2024, ku bëhet një vlerësim edhe i kuadrit ligjor dhe institucional, llojeve dhe formave të kërcënimeve dhe ndikimin e tyre në mirëqenien dhe jetën profesionale të gazetareve. Kapitulli mbyllet me përshkrimin e strukturës së raportit, ku përfshihen rekomandime që synojnë përmirësimin e mbrojtjes dhe promovimin e barazisë gjinore në mjedisin e mediave në Shqipëri.

—1.1

RRETH RRJETIT TË GAZETARËVE TË SIGURT

Me mbështetjen e Komisionit Evropian, shoqatat e gazetarëve nga vendet e Ballkanit Perëndimor kanë krijuar platformën Safejournalists.net (SJN) ¹ për të monitoruar bashkërisht ndryshimet në legjislacionin dhe praktikën e vendeve të tyre, ndërkohë që angazhohen aktivisht për forcimin e kornizave ligjore dhe institucionale që rregullojnë punën e gazetarëve dhe profesionistëve në fushën e medias. Duke përdorur metodologji kërkimore të hartuara me kujdes, SJN kryen analiza dhe hulumtime vjetore advokimi që u ofrojnë shoqatave të gazetarëve dhe

1 Shih <https://safejournalists.net/>

aktorëve të tjerë të dhëna të besueshme dhe të bazuara në prova lidhur me sfidat dhe pengesat madhore në përmbushjen e standardeve të Bashkimit Evropian (BE) për lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve në Ballkanin Perëndimor. SJN përdor dy instrumente kërkimore plotësuese për të bërë një vlerësim gjithëpërfshirës të lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve. Instrumenti i parë i hulumtimit cilësor, me titull *Treguesit e Nivelit të Lirisë së Mediave dhe Treguesi i Sigurisë së Gazetarëve*, u hartua për herë të parë në vitin 2016 dhe është përmirësuar gradualisht gjatë viteve në vazhdim. Ky instrument vlerëson tre fusha kryesore: (A) Mbrojtja ligjore; (B) Pozicioni i gazetarëve në redaksitë e lajmeve; dhe (C) Siguria e gazetarëve. Paralelisht, në vitin 2020 Rrjeti hartoi një instrument hulumtimi sasior, i njohur si *Treguesi i Sigurisë së Gazetarëve*, instrument që u testua po atë vit dhe që u zbatua në vitet 2021 dhe 2022. Ky tregues mat ndryshimet që ndodhin në sektorin e medias dhe që kanë ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në nivelin e sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve të tjerë të medias gjatë ushtrimit të profesionit. Ai është i strukturuar në katër grupe treguesish: (1) Mjedisi ligjor dhe organizativ, (2) Parandalimi i duhur, (3) Procesi i rregullt, dhe (4) Siguria aktuale.

Duke filluar që nga viti 2023, *Safejournalists.net* i ndërthuri të dy instrumentet e kërkimit (cilësor dhe sasior) në një projekt të vetëm hulumtimi për advokim, *Treguesit e Nivelit të Lirisë së Mediave dhe Treguesi i Sigurisë së Gazetarëve*², duke bërë të mundur kështu të kuptohen më qartë dhe më mirë liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoni e Veriut, Mal të Zi, Kosovë dhe Serbi) si dhe në Kroaci.

Që nga viti 2020, SJN ka hartuar raporte vjetore kërkimore advokimi për Shqipërinë³⁴, duke dokumentuar dhe vlerësuar me kujdes progresin dhe sfidat me të cilat përballet vendi për sa i përket lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve. Në Shqipëri, ky hulumtim është realizuar nën drejtimin e studiueses Blerjana Bino, e cila është autore e të gjitha raporteve vjetore, përfshirë këtu edhe këtë studim të posaçëm për gratë gazetare.

—1.2 ARSYETIMI PËR FOKUSIN NË TRAJTIMIN E SIGURISË SË GRAVE GAZETARE

Pavarësisht kuadrit aktual ligjor dhe angazhimeve ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe lirinë e medias në të gjitha vendet e SJN-së, gratë gazetare vazhdojnë të përballen me kërcënime të shumta, presione dhe kanosje të vazhdueshme. Dhuna ndaj gazetarëve mbetet një problem konstant në nivel global si dhe në Ballkanin Perëndimor, ku përfshihen sulme, ngacmime online në formën kërcënimeve për përdhunim dhe dënime me vdekje dhe formave të tjera

2 Hulumtimi i advokimit është hartuar dhe koordinuar nga Snezana Trpevska dhe Igor Micevski, bashkëpunëtorë kërkimorë të [Institutit të Kërkimeve për Zhvillimin Social RESIS](#), nga Maqedonia e Veriut.

3 Treguesit e Nivelit të Lirisë së Medias dhe Sigurisë së Gazetarëve në Shqipëri [2020](#), [2021](#), [2022](#) dhe [2023](#).

4 Treguesi i Sigurisë së Gazetarëve në Shqipëri [2020](#), [2021](#), [2022](#), [2023](#).

të kanosjes, rritje e mbikëqyrjes (survejimit), përvetësimi i identitetit dhe kërcënime të ndryshme të tjera online dhe offline.

Të dhëna të mbledhura nga SJN⁵ dhe organizata të tjera për lirinë e medias⁶ nxjerrin në pah se profesionistët e mediave shpesh bëhen objekt i formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore, përfshirë ngacmimin në botën digjitale, diskriminim në vendin e punës, kërcënime, kanosje, padi për shpifje dhe me raste edhe sulme fizike. Këto shkelje të vazhdueshme jo vetëm që cenojnë të drejtat e grave gazetare, por ndikojnë tërësisht në shëndetin e tyre psikologjik, rritjen profesionale dhe në sigurinë dhe mirëqenien personale të tyre.

Të dhënat nga raportet e Treguesit të Sigurisë së Gazetarëve, të përgatitura nga Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt⁷, tregojnë se dhuna ndaj grave gazetare raportohet shumë pak. Për shembull, në vitin 2023, SJN regjistroi gjithsej 195 raste: 37 prej tyre ishin kërcënime dhe sulme ndaj grave gazetare, 68 kërcënime ndaj gazetarëve meshkuj dhe 81 ndaj grupeve të përziera (meshkuj e femra). Këto raporte nxjerrin në pah vazhdimisht kërcënimet specifike gjinore dhe evidentojnë nevojën urgjente për masa mbrojtëse të posaçme dhe përgjigje në nivel institucional. Megjithatë, në të ardhmen duhen bërë analiza për llojet e ndryshme të dhunës dhe lidhur me arsyet pse gratë gazetare shpesh zgjedhin të mos e raportojnë dhunën që përjetojnë. Kështu, ky raport trajton në mënyrë të qartë shkeljen e të drejtave dhe sfidat me bazë gjinore që kanë përjetuar gratë gazetare gjatë viteve 2021 dhe 2025.⁸ Raporti bën një analizë me fokus të veçantë tek incidentet, tendencat dhe ndikimet dhe ofron rekomandime të bazuara në të dhëna për forcimin e kuadrit ligjor dhe praktikave mbrojtëse me qëllim krijimin e një mjedisi profesional më të sigurt për gratë gazetare dhe punonjëset e medias.

—1.3 OBJEKTI DHE STRUKTURA E RAPORTIT

Në këtë raport të posaçëm analizohen shkeljet e të drejtave me të cilat janë përballur gazetarët dhe punonjëset e medias në Shqipëri gjatë periudhës 2021 deri në 2024. Me anë të një metodologjie të hartuar nga SJN, raporti mbulon fushat kryesore të mëposhtme:

- **Kuadri ligjor dhe institucional** – Shqyrtohet legjislacioni, politikat dhe mekanizmat institucionalë kombëtarë që lidhen me sigurinë e grave gazetare si dhe detyrimet dhe standardet ndërkombëtare të Shqipërisë lidhur

5 Të gjitha incidentet e monitoruara dhe të regjistruara nga Rrjeti SafeJournalists Network për Shqipërinë që nga viti 2020 gjenden [këtu](#). Canga, E., Xhaferaj, O., et al. (2024). [Raporti Vjetor 2024: Ndjekja e Progresit të Shqipërisë në Lirinë e Medias dhe Sigurinë Gazetare në Përputhje me Standardet e BE-së](#). BIRN Albania dhe SCiDEV.

7 Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt (SJN) është një rrjet informal rajonal që bën bashkë shoqatat e gazetarëve nga shtatë vende të Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia) dhe Kroacia. Një nga aktivitetet kryesore të rrjetit është monitorimi i situatës me lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve, situatë që pasqyrohet në [një bazë të dhënash online lidhur me sulmet kundër gazetarëve](#), si dhe në [raportet \(krahasese\) vjetore kombëtare e rajonale](#).

8 Përveç të dhënave, burimeve dhe ekspertizës së ofruar nga Rrjeti SafeJournalists, një tjetër kontribut për këtë raport erdhi në formën e mbështetjes në terren nga Ina Allkanjari dhe Iris Shehaj, eksperte të Qendrës SCiDEV. Angazhimi i tyre vjen në kuadër të Projektit ["Forcimi i Lirisë së Medias, Profesionalizmit dhe Sigurisë së Gazetarëve në Shqipëri"](#), zbatuar nga BIRN Albania, Qendra SCiDEV dhe Fakteje dhe i financuar nga Bashkimi Evropian.

me lirinë e medias dhe barazinë gjinore, ku përfshihet edhe një analizë e shkurtër e efektivitetit, mangësive dhe sfidave strukturore për trajtimin e kërcënimeve specifike gjinore me të cilat përballen gratë gazetare.

- **Llojet dhe tendencat e shkeljeve** – Bëhet një analizë e kërcënimeve fizike dhe verbale, e ngacmimeve në platformat digjitale, diskriminimit në vendin e punës, kanosjeve, censurës dhe kërcënimeve me padi ligjore që synojnë posaçërisht gratë gazetare në Shqipëri, siç monitorohet nga SJN dhe bazohet në intervista të thelluara me gazetare dhe punonjëse të sektorit të medias.
- **Ndikimi të gratë gazetare** – Bëhet një vlerësim se si këto shkelje ndikojnë në mirëqenien psikologjike, në mundësitë për karrierë dhe sigurinë personale të grave gazetare, dhe se si këto ndikime në fund të fundit dëmtojnë pluralizmin dhe lirinë e mediave. Kjo analizë mbështetet tek të dhënat që sigurohen nga Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt, nga raporte të pavarura dhe intervista me gra gazetare dhe punonjëse të medias, ekspertë dhe aktorë të tjerë.
- **Përfundime dhe rekomandime** – Rekomandimet e bazuara në të dhëna të hartuara posaçërisht për politikëbërësit, mediat në vend, autoritetet ligjzbatuese dhe shoqërinë civile synojnë rritjen e mbrojtjes efektive, promovimin e barazisë gjinore dhe përmirësimin e sigurisë dhe kushteve të përgjithshme të punës për gratë gazetare.

Duke nxjerrë në pah problematikat specifike gjinore dhe duke ofruar rekomandime të qarta, me raport synohet të rriten përpjekjet për advokim, të ofrohen të dhëna për diskutime lidhur me politikat, të nxiten sinergji për nisma të tjera dhe të ndihmohet në ndërmarrjen e hapave të parapërgatitur drejt një mjedisi mediatik më të sigurt dhe më gjithëpërfshirës në Shqipëri.



Metodologjia

- Për këtë raport u përdor një metodologji kërkimore cilësore dhe eksploruese e hartuar posaçërisht nga SJN për të analizuar sigurinë, të drejtat dhe përvojat profesionale të grave gazetare në Shqipëri. Për të bërë të mundur një analizë gjithëpërfshirëse, me këtë metodologji u ndërthurën shqyrtimi i literaturës, të dhënat parësore cilësore të mbledhura përmes intervistave të thelluara dhe diskutimeve në fokus grupe online. Në këtë metodologji janë përfshirë edhe njohuri nga konsultimet me aktorë dhe ngjarjet përkatëse publike. Raporti është strukturuar për t'iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme kërkimore:
- Cilat janë rreziqet e sigurisë së grave gazetare dhe si i ndikojnë ato?
- Cilat janë format e dhunës dhe të diskriminimit me të cilat përballen më së shpeshti gratë gazetare?
- Pse gazetaret zgjedhin të mos e raportojnë dhunën dhe cili është reagimi dhe mbështetja institucionale kur ato raportojnë raste dhune?

Shqyrtimi i literaturës përbën bazën e këtij studimi, duke u mbështetur në korniza dhe standarde ndërkombëtare, të tilla si Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW), Konventa e Stambollit dhe udhëzimet dhe raportet përkatëse nga UNESCO, Kombet e Bashkuara, Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian. Përveç kësaj, u analizuan legjislacioni shqiptar dhe dokumentet strategjike për barazinë gjinore, dhunën ndaj grave dhe lirinë e medias. Në këtë shqyrtim gjithëpërfshirës u përfshinë edhe hulumtime dhe raporte të mëparshme avokimi të publikuara nga SJN.

Mbledhja e të dhënave parësore u krye gjatë periudhës dhjetor 2024 - mars 2025 përmes intervistave gjysmë të strukturuar dhe diskutimeve në fokus grupe online. U kryen gjithsej katërmëdhjetë intervista të thelluara, gjysmë të strukturuar. Mes tyre, pesë u realizuan me gra gazetare që kishin përjetuar drejtpërdrejt dhunë, ngacmim ose kërcënime që lidhej me punën e tyre në gazetari. Këto pjesëmarrëse vinin nga një gamë e gjerë mediash, përfshirë këtu programe

kombëtare investigative, kanale të njohura televizive private, media rajonale online dhe transmetues lajmesh politike.

Nga ana tjetër, u zhvilluan njëmbëdhjetë intervista të tjera të thelluara me gra gazetare që përfaqësonin lloje të ndryshme mediash, përfshirë transmetues kombëtarë (televizione publike dhe private), media e shkruar dhe portale të njohura lajmesh. Këto intervista u pasuruan me perspektivat dhe njohuritë nga ekspertë të medias, përfaqësues të shoqatave të gazetarëve, aktorë institucionalë dhe organizata të shoqërisë civile, duke ofruar një pamje më gjithëpërfshirëse për sigurinë profesionale, reagimin e institucioneve dhe efektivitetin e mekanizmave aktualë mbrojtës. Po ashtu, u zhvillua një intervistë me një ekspert ligjor i specializuar në lirinë e medias dhe të drejtat e njeriut për të ofruar njohuri mbi kuadrin ligjor në fuqi dhe zbatimin e tij në praktikë.

Tabela 1: Intervistat e kryera tek e tek (dhjetor 2024 – mars 2025)

Emri	Pozicioni/Roli	Lloji i medias
Gazetare (viktimë sulmesh)	Gazetare investigative	Media private, TV
Gazetare (viktimë sulmesh)	Gazetare (Siguria ushqimore dhe bujqësia)	TV me licencë kombëtare
Gazetare (viktimë sulmesh)	Gazetare	Media private, TV
Gazetare (viktimë sulmesh)	Gazetare	Media lokale satirike online
Gazetare (viktimë sulmesh)	Gazetare politike	Media private, TV
Gazetare	Gazetare politike	Media private vetëm për lajme, TV
Gazetare	Gazetare dhe moderatorë	Transmetues publik
Gazetare	Gazetare e kronikës	Media private, TV
Gazetare	Gazetare politike	Shtyp
Gazetare	Gazetare	TV me licencë kombëtare
Gazetare	Redaktore	Media private, TV
Gazetar	Kryetar i Shoqatës së Gazetarëve të Shqipërisë	Shoqatë
Ekspert medias	Ekspert i pavarur mediash	Organizatë e shoqërisë civile
Jurist	Ekspert ligjor	Organizatë e shoqërisë civile

Për shkak të çështjeve praktike, diskutimi në fokus grup online i planifikuar fillimisht me kryeredaktorët u përshtat për të përfshirë një seancë me fokus grup të përbërë nga redaktorë nga mediat kryesore dhe ato jofitimprurëse. Përveç kësaj, u zhvilluan me sukses diskutime në dy fokus grupe online që kishin në fokus posaçërisht gratë gazetare, në një total prej njëmbëdhjetë pjesëmarrëse femra. Në këto fokus grupe u përfatuan të dhëna të pasura cilësore lidhur me përvojat personale të dhunës dhe diskriminimit, perceptimet për sigurinë dhe efektivitetin e perceptuar të reagimit të institucioneve dhe mekanizmave mbështetës.

Tabela 2: Diskutimet në fokus grupe online të realizuara (dhjetor 2024 – mars 2025)

Grupi i pjesëmarrësve	Numri i pjesëmarrësve	Temat kryesore të diskutuara
Kryeredaktore (1 media kryesore, 3 media jofitimprurëse)	4 (gra)	Politikat editoriale, reagimi i institucioneve ndaj kërcënimeve dhe rreziqeve të sigurisë me të cilat përballen gazetaret
Gra gazetare (grupi 1)	6	Përjetimet e dhunës, diskriminimit, reagimi i institucioneve dhe mekanizmat e mbështetjes
Gra gazetare (grupi 2)	5	Rreziqet e sigurisë, kërcënimet online, ngacmimet dhe perceptimet për sigurinë

Raporti u pasurua edhe më tej me njohuritë e përftuara nga dy ngjarje të mëdha publike: një konsultim me aktorët kryesorë për projekt-protokollin e Policisë së Shtetit për sigurinë e gazetarëve⁹ dhe një seminar i posaçëm me prokurorët shqiptarë ku u trajtuan sfidat lidhur me ndjekjen penale të rasteve të kanosjeve dhe dhunës ndaj gazetarëve.¹⁰ Këto aktivitete ofruan informacione të dobishme kontekstuale, perspektivat e institucioneve si dhe rekomandime praktike për përmirësimin e bashkëpunimit dhe efektivitetit të reagimit mes profesionistëve të medias, institucioneve të zbatimit të ligjit dhe organeve gjyqësore.

Të gjitha këto aktivitete hulumtuese u realizuan në përputhje të plotë me standardet e përpikta të etikës, duke siguruar pëlqimin e informuar të pjesëmarrësve, konfidencialitetin dhe anonimatit e tyre gjatë gjithë procesit. Intervistat dhe diskutimet në fokus grupe u regjistruan vetëm me pëlqimin e shprehur qartë nga pjesëmarrësit. Më pas ato u zbardhën, u anonimizuan dhe u ruajtën në një vend të sigurt. Aty ku u dha pëlqimi, pjesëmarrësit u cituan në mënyrë të drejtpërdrejtë. Të dhënat cilësore të mbledhura u analizuan sipas tematikës dhe gjetjet u organizuan në tre dimensioneve kryesore: (i) rreziqet e sigurisë për gratë gazetare; (ii) format e veçanta të dhunës dhe diskriminimit të hasur prej tyre; dhe (iii) ndikimi në mirëqenien psikologjike, karrierën profesionale, raportimin dhe sigurinë personale.

Ndonëse kjo metodologji u zbatua me rigorozitet, hulumtuesit janë të ndërgjegjshëm se ajo ka disa kufizime, si mundësia për raportim të pamjaftueshëm për shkak të frikës së pjesëmarrësve nga stigma ose hakmarrja, natyra vullnetare e pjesëmarrjes, gjë që mund të ndikojë në përfaqësueshmërinë e tyre, dhe vështirësinë e natyrshme për diskutimin hapur të përvojave të hidhura të dhunës dhe ngacmimit. Analiza në këtë raport u pasurua më tej me të dhëna nga një sondazh i kohëve të fundit me gazetarët në Shqipëri¹¹ si dhe nga gjetje të raportimeve të tjera të pavarura lidhur me sigurinë e gazetarëve dhe lirinë e medias. Përveç kësaj, janë përfshirë edhe të dhëna të marra përmes kërkesave në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit.

9 Ky konsultim u mbajt si pjesë e nismës së Këshillit të Evropës "Mbrotja e Lirisë së Shprehjes dhe Medias në Shqipëri" (PRO-FREX), në kuadër të programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë" (Instrumenti Horizontal III) 2023 – 2026. [Kliko këtu për më shumë informacion.](#)

10 Ky seminar u mbajt më 3 mars 2025 në kuadër të Projektit "Forcimi i Sigurisë së Gazetarëve nëpërmjet Bashkëpunimit të Aktorëve të Angazhuar dhe Ngritjes së Kapaciteteve të Gazetarëve në Shqipëri", i zbatuar nga SCiDEV në bashkëpunim me Citizens Channel dhe Free Press Unlimited, me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Shqipëri. [Klikoni këtu për më shumë informacion.](#)

11 Canga, E., Xhaferaj, O., et al. (2024). [Raporti Vjetor 2024: Ndjekja e Progresit të Shqipërisë në Lirinë e Medias dhe Sigurinë Gazetare në Përputhje me Standardet e BE-së](#). BIRN Albania dhe SCiDEV.



Siguria e grave gazetare dhe dhuna me bazë gjinore në gazetari – Kuadri ndërkombëtar

Dhuna me bazë gjinore mbetet një shqetësim serioz në shumë profesione, përfshirë këtu edhe gazetarinë.¹² Gratë gazetare përballen me një lloj rreziku të pazakontë dhe të ndërlikuar, duke përjetuar dhunë si për shkak të profesionit të tyre në media ashtu edhe për shkak të gjinisë. Pavarësisht rritjes së ndërgjegjësimit në nivel botëror, dhuna me bazë gjinore ndaj grave gazetare vazhdon të mos raportohet sa duhet dhe të mos trajtohet mjaftueshëm nga mekanizmat shoqërorë dhe institucionalë.

— 3.1

NDIKIMI I DHUNËS ME BAZË GJINORE TEK GRATË GAZETARE DHE TE MEDIAT

Gratë gazetare, përfshirë këtu edhe ato të pavarura, ndërmjetësueset dhe punonjëset e tjera të mediave, shpesh përballen me kërcënime fizike, dhunë psikologjike dhe ngacmime digjitale që janë qartësisht të lidhura me gjininë. Këto forma abuzimi kanë një ndikim të madh në punën e tyre profesionale dhe mirëqenien personale, duke shkaktuar shpesh trauma të vazhdueshme dhe duke penguar ecjen përpara në karrierë për to. Faktorë të tjerë të ndërthurur, siç janë etnia, orientimi seksual, mosha ose statusi i të qenit gazetare e pavarur, i përkeqësojnë më tej këto problematika, duke nxjerrë në pah nevojën për mbështetje institucionale gjithëpërfshirëse dhe të përshtatur me nevojat e gazetareve.

Në përgjigje të kërcënimeve globale në rritje, në vitin 2020 UNESCO ndërmori nismën *Gazetari pa Frikë ose Favore*¹³ për të trajtuar pikërisht ngacmimin seksual dhe diskriminimin dhe dhunën me bazë gjinore me të cilën përballen gratë gazetare në mbarë botën. Hulumtimet e mëpasshme të UNESCO-s nxorën në pah një përhapje në nivele shqetësuese të qëndrimeve të drejtuesve të redaksive të cilët fajësonin viktimat nga kur këto të fundit raportonin ngacmimet online.¹⁴ Nga ana tjetër, Shoqata Botërore e Botuesve të Lajmeve ka theksuar se

12 Dhuna ndaj grave përkufizohet si "çdo akt dhune me bazë gjinore që rezulton, ose ka të ngjarë të rezultojë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale ose psikologjike ndaj grave, përfshirë këtu kërcënimet për akte të tilla, shtrëngimin ose heqjen arbitrare të lirisë, pavarësisht nëse ndodh në jetën publike apo private" (Neni 1 i Deklaratës për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave).

13 Shih [këtu](#).

14 UNESCO, [Gender-sensitive safety policies for newsrooms: guidelines + checklist](#) (Paris: UNESCO, 2021).

ngacmimi seksual dhe dhuna me bazë gjinore në media kanë pasoja serioze për to.¹⁵ Disa prej këtyre pasojave janë ulja e produktivitetit, dobësimi i punës në grup, rënia e besimit të stafit, numri në rritje i largimeve të punonjësve dhe kosto të mëdha financiare që lidhen me këto largime nga puna. Si rezultat, mediat përballen me rreziqe të mëdha lidhur me reputacionin e tyre, gjë që mund të ndikojë dukshëm në besimin e publikut tek to. Prandaj, trajtimi i dhunës me bazë gjinore kërkon një qasje gjithëpërfshirëse, përfshirë këtu politika efikase të brendshme, mekanizma të konsoliduara raportimi dhe kuadër mbështetëse gjithëpërfshirës.

Sipas Raportit të Raportuesit Special "Dhunën ndaj grave, shkaqet dhe pasojat e saj në luftën kundër dhunës ndaj grave gazetare", të miratuar në vitin 2020 nga Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut¹⁶, dhuna ndaj grave është një epidemi globale që prek një në tre gra në mbarë botën gjatë gjithë jetës së tyre. Kjo dhunë e përhapur nxit kulturën e normalizimit dhe tolerancës ndaj saj, që do të thotë se gazetaret dhe punonjëset e mediave shpesh veprojnë në mjedise ku dhuna sistematike dhe strukturore me bazë gjinore është pjesë e realitetit të tyre të përditshëm. Ato bëhen pre e formave të ndryshme të dhunës dhe abuzimit me bazë gjinore, përfshirë këtu edhe përdhunimin dhe ngacmimin seksual në redaksi dhe në terren, dhe i formave të tjera të kanosjes, si kërcënimet ndaj familjarëve të tyre.

Gratë gazetare që mbulojnë protesta dhe trazira përballen me një rrezik gjithnjë e më të madh për sulme seksuale, ku shumë prej tyre përjetojnë ngacmime apo provokime. Gjithsesi, vetëm disa prej tyre kanë dalë hapur kundër dhe i kanë raportuar këto incidente. Edhe ato gazetare që raportojnë për çështjet feministe vihen në shënjestër për shkak të natyrës së punës së tyre, shpesh duke mbuluar histori që kanë ndihmuar në ndryshimin e qëndrimeve publike dhe kanë kontribuar në refuzimin gjithnjë e më të madh të dhunës me bazë gjinore si një shkelje e të drejtave të njeriut.

— 3.2 NDËRSEKSIONALITETI DHE DOBËSITË SPECIFIKE

Gratë gazetare me identitete dhe dobësi të ndërthurura - përfshirë gazetaret e pavarura, ndërmjetësueset, pakicat etnike dhe racore, individët LGBTQ+, gazetaret e reja në moshë dhe ato që punojnë në zona rurale ose të marginalizuara - shpesh përballen me rreziqe të mëdha lidhur me sigurinë dhe diskriminimin. Këto dobësi tashmë të përkeqësuar theksohen edhe më shumë kur ato raportojnë për tema me ndjeshmëri politike, si korrupsioni, abuzimet me të drejtat e njeriut apo konfliktet.

Për më tepër, këto rreziqe përkeqësohen edhe më shumë nga kulturat që mbizotëron në redaksitë e lajmeve, të cilat shpesh

15 Shih [këtu](#).

16 Shih [A/HRC/44/52](#)

kanë në përbërje vetëm meshkuj. Në mjedise të tilla, ngacmimi në të shumtën e rasteve merr formën e komenteve përçmuese dhe seksiste, përpjekjeve për të minuar besueshmërinë profesionale si dhe të përjashtimit sistematik nga pozicione të profilit të lartë, vendimmarrjes editoriale dhe mundësive për ecje në karrierë. Këto praktika jo vetëm që delegjitojnë kontributet profesionale të grave, por edhe dekurajojnë në mënyrë aktive pjesëmarrjen e tyre në diskursin publik, duke minuar kështu pluralizmin e medias dhe përfaqësimin demokratik.

— 3.3

ANGAZHIMET NDËRKOMBËTARE PËR ELIMINIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE

CEDAW¹⁷ jep një përcaktim të qartë të dhunës me bazë gjinore, duke e përkufizuar si përfshirje në praktika të dëmshme kulturore, ideologjike dhe politike të drejtuara ndaj grave profesioniste, përfshirë gazetaret, politikanet dhe mbrojtëset e të drejtave të njeriut. CEDAW i detyron shtetet nënshkruese të eliminojnë të gjitha format e diskriminimit ndaj grave dhe u kërkon atyre të ndërmarrin fushata ndërgjegjësimi përmes masmediave me synim çmontimin e stereotipeve gjinore dhe pengesave ndaj pjesëmarrjes aktive publike të grave, duke mbështetur kështu në mënyrë të tërthortë rolet e grave në gazetari.

Në këtë kontekst, është me po aq rëndësi të evidentohet Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 35 i CEDAW-t lidhur me dhunën me bazë gjinore ndaj grave¹⁸, ku pohohet se praktikatat e dëmshme dhe krimet kundër grave, mbrojtëseve të të drejtave të njeriut, politikanëve, aktivistëve ose gazetarëve përbëjnë forma të dhunës me bazë gjinore ndaj grave, praktika që janë formuar nga faktorë kulturorë, ideologjikë dhe politikë.

Një tjetër kuadër ligjor i rëndësishëm që trajton dhunën me bazë gjinore është Konventa e Stambollit¹⁹ e Këshillit të Evropës, e miratuar në vitin 2011. Edhe pse Konventa nuk i referohet gazetarëve fjalë për fjalë, dispozitat e saj gjithëpërfshirëse e shtrijnë me efektivitet mbrojtjen edhe tek gratë gazetare në rolet e tyre profesionale. Si traktati ndërkombëtar më i detajuar për parandalimin e dhunës ndaj grave, kjo Konventë ofron një qasje të gjerë dhe të gjithanshme, duke trajtuar dhunën fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike në një mënyrë gjithëpërfshirëse.

Gjatë monitorimit të zbatimit të Konventës së Stambollit, Grupi i Ekspertëve për Veprime Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO)²⁰ ka ngritur shqetësime serioze lidhur me dhunën me bazë gjinore online dhe të shprehur në forma digjitale. Sipas Rekomandimit Nr. 1 të GREVIO-s, dhuna digjitale me bazë gjinore prek në mënyrë disproporcionale gratë

17 Shih [CEDAW](#)

18 Shih [Rekomandimin e përgjithshëm nr. 35 të CEDAW](#)

19 Shih [Konventën e Stambollit](#)

20 Shih [GREVIO](#)

gazetare, mbrojtëset e të drejtave të njeriut, figurat politike dhe individët me prani të konsiderueshme në sferën publike, siç janë influencersit në mediat sociale. GREVIO e klasifikon qartësisht këtë fenomen jo vetëm si një formë e dhunës me bazë gjinore, por edhe si një shkelje serioze e të drejtave të grave në përgjithësi sipas të drejtës ndërkombëtare.

Shënjestrimi sistematik i grave gazetare me dhunë online konfirmohet më tej nga sondazhi i UNESCO-ICFJ, ku gati tre të katërtat (73%) e të anketuarve që identifikohen si gra raportuan se kanë përjetuar dhunë online gjatë punës së tyre²¹. Po ashtu, GREVIO thekson se, edhe pse dhuna online shprehimisht mund të mos jetë gjithmonë vepër penale, ajo mund të sjellë dëme të mëdha psikologjike për shkak të natyrës së saj përsëritëse, dinamikës së turmës dhe përhapjes së shpejtë të përmbajtjes së dëmshme përmes platformave digjitale.

Për më tepër, GREVIO thekson nevojën për t'u përballur me strukturat e pushtetit të rrënjosura dhe të dominuara nga meshkujt në media dhe bën thirrje për reforma strukturore që promovojnë barazinë, diversitetin dhe sigurinë e grave gazetare, veçanërisht atyre që janë të cënueshme për shkaqe të ndryshme (si gjinia, orientimi seksual, etnia, etj.).²²

Plani i Veprimit për Sigurinë e Gazetarëve i Kombeve të Bashkuara²³ ka ndikuar ndjeshëm në përpjekjet botërore duke nxitur shtetet të hartojnë kuadrin ligjor në mbrojtje të gazetarëve ndaj kërcënimeve si online ashtu edhe offline, me vëmendje të veçantë ndaj dobësive me të cilat përballen gratë gazetare. Është për t'u theksuar se plani mbështet një ndryshim në terminologji, nga "dhuna ndaj grave gazetare" në "dhunë me bazë gjinore në gazetari", për të pasqyruar më saktë gjithëpërfshirjen dhe për të pranuar përvojat e ndryshme të individëve në profesionin e gazetarisë që përballen me rreziqet në rritje.²⁴

Për të përforcuar më tej angazhimin ndërkombëtar, Rezoluta 72/175 e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së u bën thirrje në mënyrë të qartë shteteve anëtare të njohin dhe të adresojnë me masa paraprake sulmet që prekin në mënyrë disproporcionale gratë gazetare.²⁵ Po ashtu, Rezoluta 33/2 (2016)²⁶ e Këshillit të të Drejtave të Njeriut të OKB-së (KDNJ) dënon unanimisht sulmet me shënjestër gratë gazetare, duke denoncuar shprehimisht diskriminimin seksual dhe gjinor, dhunën, kanosjen dhe ngacmimin që ndodhin si në mjediset digjitale ashtu edhe në ato fizike.²⁷ Përveç kësaj, Deklarata për Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut²⁸ i detyron shtetet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur individët, përfshirë gazetarët, nga dhuna, kërcënimet, hakmarrja dhe diskriminimi që vijnë për shkak të punës së tyre legjitime në mbrojtje të të drejtave të njeriut.

21 Jordaans, L. (9 Tetor 2023). [Global guidelines for monitoring online violence against female journalists](#). (Udhëzimet globale për monitorimin e dhunës online kundër gazetarëve gra). WAN-IFRA.

22 GREVIO. [Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 1 për dimensionin digjital të dhunës kundër grave](#), f. 24, 2021.

23 Shih [këtu](#).

24 UNESCO. (2022). [Rezultatet e Konsultimeve Rajonale dhe Tematike](#).

25 Neni 19 (2019) Fundi i pandëshkueshmërisë. [Aksion sipas standardeve të OKB-së për sigurinë e gazetarëve](#).

26 Shih [këtu](#).

27 Këshilli i të Drejtave të Njeriut (2020). [Lufta kundër dhunës ndaj grave gazetare](#) - Raporti i Raportuesit Special për Dhunën ndaj Grave, Shkaqet dhe Pasojat e saj.

28 Shih [këtu](#).

— 3.4

KORNIZAT E BASHKIMIT EVROPIAN PËR MBROJTJEN E GRAVE GAZETARE

Bashkimi Evropian ka krijuar kuadër të fortë politikash dhe ligjor të hartuara për të forcuar sigurinë dhe fuqizimin e grave që punojnë në gazetari dhe në sektorin e gjerë të medias. Rekomandimi i Komisionit të BE-së (BE) 2021/1534 për mbrojtjen, sigurinë dhe fuqizimin e gazetarëve dhe profesionistëve të medias²⁹ evidenton më së qarti rolin e rëndësishëm që luajnë shoqëria civile dhe mediat në luftën kundër ngacmimeve, kërcënimeve, diskriminimit dhe nxitjes së urrejtjes si online ashtu edhe offline, veçanërisht ato që synojnë gratë gazetare, grupet e pakicave dhe ato që raportojnë për çështje që lidhen me barazinë.

Për më tepër, Direktiva e BE-së 2024/1385 për Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje³⁰ shënon një përparim të rëndësishëm ligjor në sigurimin e mbrojtjes gjithëpërfshirëse për gratë dhe vajzat, përfshirë këtu dispozita të posaçme që trajtojnë dhunën në hapësirat digjitale. Për gratë gazetare, kjo direktivë i përcakton Shteteve Anëtare të BE-së detyrim të drejtpërdrejtë për të miratuar dhe zbatuar politika që i mbrojnë gratë gazetare nga ngacmimi dhe abuzimi, si online ashtu edhe fizikisht, duke përmirësuar kështu sigurinë e tyre në mjediset profesionale. Për të plotësuar këto instrumente, Plani i Veprimit Gjinnor i BE-së (GAP III, 2021-2025)³¹ e çon në një stad të mëtejshëm barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave përmes një qasjeje të qartë transformuese gjinore dhe gjithëpërfshirëse. Të marra së bashku, këto korniza të BE-së nënvizojnë nevojën për përgjigje të parapërgatitur institucionale dhe politike. Pavarësisht standardeve të konsoliduara ndërkombëtare dhe advokimit të vazhdueshëm, dhuna me bazë gjinore në gazetari mbetet kryesisht shumë pak e raportuar. Kjo vjen përgjithësisht për shkak të stigmës së vazhdueshme kulturore, frikës nga pasojat profesionale dhe reagimit të pamjaftueshëm institucional. Thyerja e kësaj “kulture heshtjeje” kërkon reforma strukturore, mekanizma të aksesueshëm dhe transparentë për raportimin e dhunës, zbatim efektiv të masave mbrojtëse dhe ndryshime të gjera shoqërore dhe organizative.

29 [Rekomandimi i Komisionit \(BE\) 2021/1534](#) i datës 16 shtator 2021 për Sigurimin e Mbrojtjes, Sigurisë dhe Fuqizimit të Gazetarëve dhe Profesionistëve të Tjerë të Medias në Bashkimin Evropian.

30 Shih [Direktivën \(BE\) 2024/1385 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit i 14 majit 2024 për Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje](#).

31 Shih [këtu](#).

IV

Kuadri kombëtar në mbrojtje të grave gazetare

Në këtë kapitull bëhet një analizë e kuadrit ligjor dhe institucional kombëtar të Shqipërisë për mbrojtjen e grave gazetare. Në të shqyrtohen garancitë kushtetuese, legjislacioni penal, ligjet për barazinë gjinore dhe antidiskriminimin, të drejtat e punës dhe dispozitat për sigurinë në vendin e punës, si dhe përgjigjet ndaj dhunës digjitale, duke nxjerrë në pah mangësi serioze në adresimin e dobësive të veçanta me të cilat përballen gratë gazetare. Duke përdorur një perspektivë kritike, analiza nxjerr në pah kufizimet e ligjeve në fuqi, dobësitë institucionale dhe mangësitë në zbatimin e tyre, dhe bën thirrje për marrjen e masave gjithëpërfshirëse që kanë një fokus të përcaktuar qartë dhe që janë të përshtatura për të trajtuar dhunën me bazë gjinore në gazetari.

— 4.1

GARANCITË KUSHTETUESE DHE PARIMET E PËRGJITHSHME

Gazetarët dhe profesionistët e medias në Shqipëri përballen rregullisht me kërcënime, ngacmime dhe kanosje, duke dëmtuar cilësinë e punës së tyre në gazetari, sigurinë dhe besimin e publikut.³² Edhe pse Shqipëria është angazhuar zyrtarisht për lirinë e shprehjes dhe barazinë gjinore dhe ka ecur përpara me legjislacionin përkatës kombëtar, mbeten ende boshllëqe të mëdha në sigurimin e mbrojtjes gjithëpërfshirëse që trajton dhunën me bazë gjinore ndaj grave gazetare në veçanti.³³ Këto mangësi përkeqësohen më tej nga dobësitë e ndërthurura, përfshirë këtu vështirësitë ekonomike, punën si gazetarë të pavarur ose punësim i pasigurt dhe përkatësinë apo lidhjen me grupe etnike ose shoqërore të marginalizuara.

Kushtetuta e Shqipërisë garanton në mënyrë të qartë barazinë gjinore, me nenin 18/2 ku thotë: “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja

32 Reporterët pa kufi. (2004). [Renditja e Shqipërisë– Treguesi i Lirisë së Medias në Botë](#).

33 Bino, B. (2024). [Treguesit e nivelit të lirisë së medias dhe Indeksi i sigurisë së gazetarëve 2023](#). Safejournalists.net.

ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.”³⁴ Ky parim kushtetues përforcohet nga Ligji Nr. 9770 “Për barazinë gjinore në shoqëri”³⁵, i cili përcakton dispozitat kryesore për të promovuar barazinë gjinore dhe për të siguruar mundësi të barabarta në jetën publike dhe në mjediset profesionale. Në përputhje me standardet ndërkombëtare, Shqipëria nënshkroi Konventën e Stambollit (Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje) më 19 dhjetor 2011 dhe e ratifikoi atë pa rezerva më 4 shkurt 2013.³⁶ Edhe pse vendi raporton rregullisht lidhur me progresin në Këshillin e Evropës, mbeten ende mangësi të konsiderueshme në zbatimin e plotë të Konventës, veçanërisht në sigurimin e mbrojtjeve të posaçme dhe mekanizmave mbështetës të përshtatur për nevojat e grave gazetare.³⁷ Gjithsesi, ndonëse këto dispozita kushtetuese krijojnë një bazë të rëndësishme ligjore, ndikimi i tyre mbetet i kufizuar në mungesë të masave të posaçme legjislative dhe mekanizmave institucionalë që adresojnë posaçërisht dobësitë unike me të cilat përballen gratë gazetare.

Mbrojtjet kushtetuese, edhe pse jashtëzakonisht të rëndësishme, nuk përkthehen domosdoshmërisht në mbrojtje të posaçme kundër dhunës me bazë gjinore në mjediset e gazetarisë profesionale. Pa një kuadër të plotë ligjor, udhëzime të qarta dhe mekanizma efektivë për zbatimin e tij që pranojnë ndërthurjen e gjinisë dhe punës në gazetari, këto garanci kushtetuese më vete nuk arrijnë t’u sigurojnë grave gazetare mbrojtje të mirëfilltë nga dhuna, ngacmimi dhe diskriminimi.

— 4.2 LEGJISLACIONI PENAL DHE BOSHLLËQET E KAPACITETEVE INSTITUCIONALE PËR GRATË GAZETARE

Kodi Penal shqiptar e trajton dhunën me bazë gjinore kryesisht përmes dispozitave për dhunën në familje (Neni 130/a), dhunën seksuale (Neni 102/a) dhe ngacmimin seksual (Neni 108/a).³⁸ Edhe pse Neni 108/a nuk i referohet shprehimisht ngacmimit seksual online, gjuha e tij – “Kryerja e sjelljeve me natyrë seksuale, që cenojnë dinjitetin e një personi, me çdo mjet ose formë” – mund të interpretohet se përfshin abuzimin e bërë të mundur nga teknologjia. Shqipëria është aktualisht në procesin e hartimit të një kodi të ri penal, ku ngacmimi seksual përmes shërbimeve publike të komunikimit online ose pajisjeve elektronike digjitale propozohet të konsiderohet shprehimisht vepër penale.³⁹ Edhe pse këto dispozita përputhen gjerësisht me standardet ndërkombëtare, përfshirë këtu ato që përcaktohen nga Konventa e Stambollit, zbatueshmëria e tyre e

34 [Kushtetuta e Shqipërisë](#).

35 [Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri”](#).

36 [Konventa e Stambollit, Shqipëria](#).

37 Siç evidentohet në katër raporte të njëpasnjëshme nga Rrjeti SafeJournalists për Indeksin e Sigurisë së Gazetarëve [2020](#), [2021](#), [2022](#), [2023](#).

38 [Kodi Penal](#).

39 Në kohën e publikimit, drafti i Kodit Penal nuk ishte ende i hapur për konsultim publik dhe propozimet fillestare mund t’i nënshtrohen rishikimeve të mëtejshme.

drejtpërdrejtë në kontekste specifike profesionale dhe rreziqet e shtuara me të cilat përballen gratë gazetare mbetet e kufizuar.⁴⁰ Ndonëse Kodi Penal përfshin dispozita për dhunën ndaj grave, ai nuk i njeh gratë gazetare si një kategori më vete. Si rezultat, ai nuk arrin të adresojë rreziqet e veçanta me të cilat përballen gazetaret për shkak të roleve të tyre profesionale – rreziqe që rriten nga profesioni i tyre, shoqëruar me rritje të pranisë së tyre në publik, vëmendja e publikut tek to dhe rolet hetimore.

Veprat e tjera penale si “Fyerja” (Neni 119) dhe “Shpifja” (Neni 120) ofrojnë mbrojtje të përgjithshme, por nuk arrijnë të trajtojnë kërcënimet e veçanta dhe me shënjestër të caktuar si dhe ngacmimin në profesion me të cilat përballen zakonisht gratë gazetare. Po kështu, edhe pse Neni 84 (“Kanosja”) mund të zbatohet, në teori, për aktet e kërcënimit, zbatimi i tij në praktikë shpesh rezulton i pamjaftueshëm për shkak të vështirësive në zbatim dhe barrës së provës, veçanërisht kur kërcënimet burojnë nga burime anonime ose të tërthorta. Neni 121/a i Kodit Penal e klasifikon përndjekjen si vepër penale, ku përfshin sjelljen që synon të shkaktojë frikë ose ankth. Megjithatë, kjo dispozitë nuk adreson në mënyrë të qartë ngacmimin që lidhet drejtpërsëdrejti me punën në gazetari, veçanërisht atë që ka për objektiv gratë gazetare. Mungesa e referencës së qartë për cenueshmërinë për shkak të profesionit e bën më të dobët dobishmërinë praktike të këtij neni për mbrojtjen e grave gazetare. Për më tepër, kjo dispozitë nuk mbulon në mënyrë të qartë përndjekjen online ose përdorimin e mjeteve digjitale dhe teknologjike. Edhe pse aktualisht zbatohet në raste të tilla, këtij zbatimi i mungon një bazë e fortë ligjore. Siç u evidentua edhe më sipër, Shqipëria po harton aktualisht një kod të ri penal, i cili synon ta klasifikojë si vepër penale pikërisht përndjekjen online të kryer përmes teknologjive të informacionit dhe komunikimit.⁴¹ Kodi Penal nuk e njeh dhunën psikologjike si një formë tjetër dhune që mund të ushtrohet ndaj grave në përgjithësi dhe grave gazetare në veçanti, nga autorë të tjerë, përveç atyre me lidhje familjare/shpirtërore, gjë që e bën përmes Nenit 130/a “Dhuna në Familje”.

Nenet 237 dhe 238 të Kodit Penal, përkatësisht “Goditjet për shkak të detyrës” dhe “Kanosja për shkak të detyrës”, parashikojnë goditjet ndaj punonjësve që kryejnë detyra shtetërore ose një shërbim publik. Megjithatë, këto nene nuk kanë asnjë dispozitë që do t’i klasifikonte si vepër penale sulmet ose kërcënimet ndaj gazetarëve në përgjithësi, dhe grave gazetare në veçanti.

Pavarësisht dispozitave të qarta ligjore, zbatimi mbetet me mangësi të theksuara, veçanërisht për rastet që kanë të bëjnë me gratë gazetare. Edhe pse janë raportuar pak raste, nga monitorimi evidentohet se reagimi nga agjencitë e zbatimit të ligjit ndaj dhunës me bazë gjinore që kanë të bëjnë qartësisht me aktivitetet profesionale të gazetarëve është shpesh

40 Siç evidentohet në katër raporte të njëpasnjëshme nga Rrjeti SafeJournalists për Indeksën e Sigurisë së Gazetarëve [2020](#), [2021](#), [2022](#), [2023](#).

41 Në kohën e publikimit, drafti i Kodit Penal nuk ishte ende i hapur për konsultim publik dhe propozimet fillestare mund t’i nënshtrohen rishikimeve të mëtejshme.

jo-efikas.⁴² Një faktor kryesor që kontribuon është mungesa e protokolleve të qarta ose personelit të specializuar tek agjencitë e zbatimit të ligjit, të cilat duhet të kenë staf të trajnuar për të trajtuar kërcënimet ndaj gazetarëve, veçanërisht grave gazetare.⁴³ Masat e fundit institucionale tregojnë se po punohet për ngushtimin e hendeqeve të tilla, të shtyrë pjesërisht nga procesi i anëtarësimit të Shqipërisë në BE dhe përpjekjet e advokimit të organizatave të shoqërisë civile. Është për t'u theksuar se në nëntor të vitit 2024 Prokuroria e Përgjithshme nxori një qarkore ku udhëzonte prokurorët në të gjithë vendin që t'u jepnin përparësi hetimit të sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve. Kjo qarkore u shoqërua me emërimin e një personi kontakti të posaçëm për raste të tilla.⁴⁴ Efektiviteti i kësaj mase do të varet nga qëndrueshmëria me të cilën prokurorët dhe agjencitë e zbatimit të ligjit do ta zbatojnë atë dhe të krijojnë mekanizma reagimi. Në mars 2025, Policia e Shtetit njoftoi ngritjen e një pike kontakti në nivel kombëtar dhe nisi hartimin e një protokollit të posaçëm për sigurinë e gazetarëve, duke pranuar në mënyrë të qartë vështirësitë e veçanta me të cilat përballen gratë gazetare.⁴⁵ Megjithatë, ndikimi praktik i këtyre masave varet nga zbatimi i tyre i plotë, përfshirë trajnimin e posaçëm dhe sistematik për zyrtarët e agjencive të zbatimit të ligjit dhe miratimin e udhëzimeve të qarta me të cilat bëhen të mundur një reagim dhe përgjigje efikase ndaj kërcënimeve dhe sulmeve me bazë gjinore.

Trajnimet institucionale për agjencitë e zbatimit të ligjit, për gjyqësorin dhe autoritetet e tjera përkatëse kanë ende nevojë të përmirësohen. Edhe pse Akademia e Sigurisë e Policisë së Shtetit dhe Shkolla e Magjistraturës kanë krijuar kurrikula të përgjithshme trajnimi që mbulojnë dhunën në familje dhe dhunën seksuale, këto programe tradicionalisht kanë dështuar në trajtimin tërësor të konteksteve të veçanta dhe dobësive me të cilat përballen gratë gazetare. Në vitin 2024, Akademia e Sigurisë e Policisë së Shtetit bëri një përparim të dukshëm në këtë drejtim duke prezantuar një modul kurrikule të posaçme për lirinë e shprehjes, ku u përfshinë komponentë të veçantë për sigurinë e gazetarëve.⁴⁶ Në të njëjtën linjë, edhe Shkolla e Magjistraturës pritet të organizojë trajnime të posaçme për kanosjet dhe dhunën ndaj gazetarëve, me vëmendje të veçantë ndaj dhunës me bazë gjinore.⁴⁷ Për të plotësuar këto nisma institucionale, janë ofruar trajnime shtesë me fokus sigurinë e gazetarëve përmes projekteve dhe partneriteteve të jashtme, të mbështetura nga aktorë ndërkombëtarë që promovojnë sundimin e ligjit dhe reformën në drejtësi në Shqipëri, si dhe nga organizata vendase të financuara nga donatorë që kanë në fokus të punës së tyre pikërisht sigurinë e gazetarëve dhe lirinë e medias.⁴⁸

42 Komisioni Evropian. (2024). [Raporti i Sundimit të Ligjit 2024: Kapitulli i vendit për situatën e sundimit të ligjit në Shqipëri](#). (Bruksel, Komisioni Evropian).

43 Siç evidentohet në katër raporte të njëpasnjëshme nga Rrjeti SafeJournalists për Indeksën e Sigurisë së Gazetarëve [2020](#), [2021](#), [2022](#), [2023](#).

44 Prokuroria e Përgjithshme. (2024). [Prokurori i Përgjithshëm miraton qarkoren "Për hetimin e rasteve që lidhen me sigurinë e gazetarëve dhe të mediave"](#). (Tiranë, Prokuroria e Përgjithshme).

45 Qendra SCiDEV. (11 mars 2025). [Takim konsultativ për udhëzimin e Policisë së Shtetit për sigurinë e gazetarëve](#). (Tirana, Qendra SCiDEV).

46 Kjo u konfirmua gjatë konsultimit publik të draftit të Protokollit të Sigurisë së Gazetarëve të Policisë së Shtetit, të organizuar nga Këshilli i Evropës, SCiDEV dhe Respublica më 10 mars 2025. Nuk ka asnjë tregues të veçantë që moduli brenda Akademisë së Sigurisë përfshin komponentë të dhunës me bazë gjinore ndaj grave gazetare.

47 Canga, E., Xhaferaj, O., et al. (2024). [Raporti Vjetor 2024: Ndjekja e Progresit të Shqipërisë në Lirinë e Medias dhe Sigurinë Gazetare në Përputhje me Standardet e BE-së](#). BIRN Albania dhe SCiDEV.

48 Shih [Projektin PRO-FREX](#) të Këshillit të Evropës si shembull.

Ekziston një hendek i madh mes numrit real të incidenteve kundër gazetarëve – veçanërisht grave gazetare⁴⁹, dhe numrit të incidenteve të raportuara tek autoritetet. Kjo mospërputhje vjen kryesisht nga mosbesimi i vazhdueshëm mes gazetarëve, nga frika e hakmarjes dhe perceptimet për pamjaftueshmërinë e mekanizmave mbrojtës.⁵⁰ Edhe pse sulmet fizike nuk janë sistematike në Shqipëri⁵¹, shpeshtësia dhe ashpërsia e kërcënimeve, kanosjeve dhe formave të tjera të dhunës me bazë gjinore kundër grave gazetare mbeten të raportuara në numër shumë të ulët. Adresimi i këtyre mangësive kërkon përmirësimin e praktikave të mbledhjes së të dhënave, krijimin e kanaleve të qarta të raportimit dhe përpjekje aktive për të ringritur besimin mes gazetarëve dhe institucioneve të zbatimit të ligjit.

— 4.3 MANGËSITË NË TRAJTIMIN E DHUNËS NDAJ GRAVE GAZETARE NË HAPËSIRËN DIGJITALE

Dhuna digjitale është bërë një kërcënim serioz për sigurinë, pavarësinë profesionale dhe mirëqenien e përgjithshme të grave gazetare në Shqipëri. Në kuadrin ligjor dhe institucional të vendit vazhdon të ekzistojë një boshllëk i madh për trajtimin siç duhet të dhunës digjitale.⁵² Ky boshllëk pasqyron në të njëjtën kohë mungesën e harmonizimit të kuadrit ligjor dhe rregullator në vend me Direktivën e BE-së nr. 2024/1385, Konventën e Stambollit, Rekomandimin e parë të GREVIO-s dhe Konventën e Budapestit. Format më të zakonshme të dhunës digjitale që vihen re në Shqipëri janë raportimi i koordinuar i llogarive të mediave sociale ose postimeve në blog, tortura seksuale digjitale, shpërndarja pa pëlqim i imazheve intime, dezinformimi, lajmet e rreme ose kërcënimet e gjeneruara me inteligjencë artificiale. Në një vlerësim të GREVIO-s për vitin 2024 evidentohet një rritje e konsiderueshme e krimeve digjitale në Shqipëri, duke nënvizuar nevojën urgjente për përfshirje sa më qartë në kuadrin ligjor në vend dhe reagimin institucional të formave digjitale të dhunës me bazë gjinore.⁵³ Normat patriarkale, boshllëqet ligjore dhe klima e pandëshkueshmërisë që mbizotëron në vend kanë krijuar një mjedis në të cilin shumë përdorues të mediave sociale në Shqipëri të ndihen të inkurajuar për t'i bërë gratë aktiviste shënjestra të urrejtjes në nivele shqetësuese.⁵⁴ Përhapja e ngacmimeve të tilla online jo vetëm që shkakton dëm psikologjik dhe emocional, por prodhon edhe ankth e frikë, duke i detyruar gratë gazetare të censurojnë punën e tyre, të kufizojnë daljen në publik ose edhe të tërhiqen krejtësisht nga hapësirat publike.

49 Siç evidentohet në katër raporte të njëpasnjëshme nga Rrjeti SafeJournalists për Indeksën e Sigurisë së Gazetarëve [2020](#), [2021](#), [2022](#), [2023](#).

50 Canga, E., Xhaferaj, O., et al. (2024). [Raporti Vjetor 2024: Ndjekja e Progresit të Shqipërisë në Lirinë e Medias dhe Sigurinë Gazetare në Përputhje me Standardet e BE-së](#). BIRN Albania dhe SCiDEV.

51 Shih bazën e të dhënave të [SafeJournalists Network](#), [Media Freedom Rapid Response](#) dhe [Council of Europe Platform for the Safety of Journalists](#).

52 Reçi, M., & Kelmendi, S. (2023), [Liria për të mbrojtur të drejtat në hapësirat online: Sfidat për mbrojtëset e të drejtave të njeriut të grave në Shqipëri, në Studime rastesh mbi Gjininë dhe Sigurinë Kibernetike në Ballkanin Perëndimor](#), redaktuar nga E. Bavčić & K. Storr, Eds. (DCAF – Geneva Centre for Security Sector Governance).

53 Këshilli i Evropës: Grupi i Ekspertëve për Veprime Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO). (2024, shtator 17). [Building trust by delivering support, protection and justice: Albania](#) (GREVIO(2024)6).

54 Nensi Bogdani, ["Gratë aktiviste në Shqipëri përballen me një sërë abuzimesh online"](#), BIRN, 2023.

Për më tepër, në raportin e GREVIO-s (2024) theksohen në mënyrë të qartë mangësitë serioze në trajnimet e agjencive të zbatimit të ligjit, duke treguar përgatitjen e pamjaftueshme në trajtimin e formave digjitale të dhunës me bazë gjinore.⁵⁵ Ky boshllëk në njohuritë e posaçme tek agjencitë e zbatimit të ligjit përkeqëson cënueshmërinë e grave gazetare dhe gërryen besimin e tyre në proceset institucionale, duke bërë që shumë prej tyre të ndjehen të dekurajuar e të mos denoncojnë ngacmimet online dhe të mos kërkojnë zgjidhje juridike. Mekanizmat ekzistues të raportimit dhe mbrojtjes janë hartuar kryesisht për të adresuar dhunën në familje dhe nuk ofrojnë mbështetje të specializuar institucionale ose sistem raportimi qartësisht të përshtatur për gazetarët që përjetojnë kanosje digjitale që ka lidhje me profesionin e tyre. Ky peizazh i fragmentuar institucional u krijon një barrë të panevojshme grave gazetare, të cilat shpesh hasin në pengesa praktike dhe procedurale, duke rrezikuar viktimizimin për herë të dytë përmes proceseve të ndërlikuara dhe burokratike.

Rastet e raportuara në Policinë e Shtetit dhe në prokurori zakonisht janë të ngadalta në hetim dhe ndjekje penale, duke dëmtuar kështu besimin e gazetarëve në këtë proces. Në këtë drejtim, prokurorët kanë vënë re se numri i pakët i rasteve të denocnuara zyrtarisht e bën të vështirë justifikimin e dhënies së përparësive hetimit të rasteve të tilla. Ndjekja penale e rasteve të kanosjes ndaj gazetarëve ka vështirësi të tjera, veçanërisht kur bëhet fjalë për ngacmime anonime në internet, mbledhjen e provave të besueshme për kërcënime psikologjike dhe kapërcimin e kufizimeve të Kodit Penal në fuqi dhe kuadrit procedural. Si pasojë, këto kompleksitete procedurale dhe mungesa e klasifikimit të përparësive kontribuojnë në një ndjenjë të gjithanshme pandëshkueshmërie që rrethon dhunën digjitale, duke i dekurajuar më tej gratë gazetare në kërkimin e mbështetjes institucionale. Kjo klimë pandëshkueshmërie nxit kulturën e heshtjes, ku gratë janë më pak të motivuara të denoncojnë abuzimin digjital, sepse nuk presin përgjigje institucionale që t'ia vlejë.

— 4.4

KUADRI STRATEGJIK PËR BARAZINË GJINORE

Shqipëria ka krijuar një kuadër gjithëpërfshirës ligjor dhe institucional për trajtimin e dhunës me bazë gjinore dhe promovimin e barazisë gjinore. Megjithatë, këto instrumente mbrojtëse përqendrohen kryesisht në familje dhe kanë mangësi serioze për mbulim të plotë të rreziqeve që vijnë nga profesioni dhe me të cilat përballen gratë gazetare.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 dhe Plani i saj i Veprimit kanë dispozita të rëndësishme për luftën kundër ngacmimeve dhe dhunën në vendin e punës, përfshirë një detyrim për trajnime të rregullta vjetore

55 Këshilli i Evropës: Grupi i Ekspertëve për Veprime Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO). (2024, shtator 17). [Building trust by delivering support, protection and justice: Albania](#) (GREVIO(2024)6).

të gjyqtarëve për trajtimin e rasteve që kanë të bëjnë me ngacmim seksual, dhunë dhe diskriminim gjinor në vendin e punës⁵⁶, një dispozitë e rëndësishme duke pasur parasysh se gratë gazetare në disa raste përballen me diskriminim gjinor në vendin e punës në media.⁵⁷ Edhe pse këto masa tregojnë një progresin drejt një reagimi më të madh institucional, efektiviteti i tyre praktik mbështetet shumë në zbatimin e vazhdueshëm dhe të specializuar, monitorimin sistematik dhe mekanizmat e llogaridhënies. Aktualisht, këto programe trajnimi për gjyqësorin kanë fokus të gjerë dhe nuk adresojnë qartësisht përvojat specifike të grave gazetare ose grupeve të tjera profesionale të prekura nga dhuna me bazë gjinore jashtë mjediseve konvencionale familjare.

Një tjetër kufizim institucional që duhet evidentuar është natyra e fragmentuar e shërbimeve mbështetëse në dispozicion për gazetaret gra që përjetojnë ngacmim, kanosje ose forma të tjera të dhunës. Nuk ekziston një mekanizëm i centralizuar dhe i posaçëm që të jetë tërësisht i përshtatur për nevojat e tyre.⁵⁸ Si pasojë, gratë gazetare shpesh detyrohen të shkojnë sa në një institucion në tjetrin për të kërkuar mbështetje, duke rritur rrezikun e ritraumatizimit dhe viktimizimit për herë të dytë. Përveç kësaj, mbledhja sistematike e të dhënave mbi incidentet që kanë të bëjnë me gazetarët, veçanërisht të dhënat e ndara në kategori dhe të lidhura me dhunën me bazë gjinore, mbetet e pamjaftueshme. Ky boshllëk pengon ndjeshëm hartimin e politikave të bazuara në evidenca dhe të përgjigjeve efektive institucionale. Prandaj, pavarësisht një angazhimi të fuqishëm kombëtar për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës në familje, vazhdojnë ende mangësitë serioze në ofrimin e mekanizmave mbrojtës të posaçëm për gratë gazetare që përballen me rreziqe në profesion.

— 4.5 LIGJI KUNDËR DISKRIMINIMIT

Ligji Nr. 221 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar me Ligjin 124/2020⁵⁹, ndalon në mënyrë kategorike diskriminimin për shkaqe të ndryshme, përfshirë seksin, gjininë, etninë, orientimin seksual, statusin shoqëror, dhe ndalon në mënyrë të qartë ngacmimin, përfshirë ngacmimin seksual, në vendin e punës (Neni 12). Ky dispozitë u ofron mbrojtje grave gazetare që në disa raste përballen me diskriminim në media për shkak të gjinisë. Megjithatë, pavarësisht bazës ligjore në fuqi, ka ende mangësi serioze në adresimin e qartë të rreziqeve specifike profesionale dhe cenueshmërive të tjera të grave gazetare, veçanërisht atyre që janë të pavarura, në vështirësi ekonomike ose u përkasin grupeve shoqërore të marginalizuara. Ky boshllëk përkeqësohet nga efektiviteti i kufizuar i mekanizmave institucionalë. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, megjithëse me kompetenca ligjore për të trajtuar ankesat, për

56 [Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030](#)

57 Siç evidentohet në katër raporte të njëpasnjëshme nga Rrjeti SafeJournalists për Indeksin e Sigurisë së Gazetarëve [2020](#), [2021](#), [2022](#), [2023](#)

58 Siç evidentohet në katër raporte të njëpasnjëshme nga Rrjeti SafeJournalists për Indeksin e Sigurisë së Gazetarëve [2020](#), [2021](#), [2022](#), [2023](#)

59 [Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”](#)

të kryer hetime dhe për të vendosur sanksione administrative, ofron mbështetje të përgjithshme për të gjithë qytetarët, por të cilit i mungojnë ndërhyrjet me fokus të veçantë të gratë gazetare.⁶⁰ Si rezultat, potenciali i këtij mekanizmi për të trajtuar në mënyrë efektive sfidat me bazë gjinore në sektorin e medias mbetet i kufizuar. Nga ana tjetër, vihen re mangësi në mbledhjen sistematike dhe gjithëpërfshirëse të të dhënave lidhur me rastet e diskriminimit dhe ngacmimit me bazë gjinore kundër grave gazetare. Kjo mungesë të dhënash bëhet pengesë për monitorimin efektiv, hartimin e politikave dhe planifikimin e ndërhyrjeve të specializuara.

Edhe pse gratë gazetare janë përgjithësisht të mbrojtura nga diskriminimi, ato shpesh nuk i shfrytëzojnë plotësisht mekanizmat ligjorë që kanë në dispozicion për shkak të ndërgjegjësimit të kufizuar, procedurave të ndërlikuara ose frikës nga ndëshkimet në vendin e punës. Për më tepër, edhe pse është filluar të kuptohen dobësitë specifike profesionale, njohja e këtyre dobësive mbetet e paqëndrueshme dhe kërkon konsolidim të mëtejshëm për të siguruar mbështetje efektive institucionale.

— 4.6 TË DREJTAT E PUNËS DHE SIGURIA NË VENDIN E PUNËS

Kodi i Punës i Shqipërisë (Ligji Nr. 7961, i ndryshuar)⁶¹ ndalon shprehimisht diskriminimin dhe ngacmimin në marrëdhëniet e punës sipas Nenit 9, ndërsa Neni 32 i detyron punëdhënësit të marrin masa të forta kundër ngacmimit në vendin e punës, të shpallin politika kundër ngacmimit dhe të komunikojnë qartë sanksionet përkatëse. Pavarësisht këtyre detyrimeve të qarta ligjore, zbatimi praktik në organet e medias në Shqipëri mbetet dukshëm i kufizuar, veçanërisht në trajtimin e dobësive specifike me të cilat përballen gratë gazetare.

Një kufizim serioz është përdorimi i përhapur i praktikave të punësimit informal në media.⁶² Kontratat e shërbimit shpesh zëvendësojnë kontratat formale të punës, ku preken veçanërisht gazetarët që punojnë në rrethe ose media më të vogla, duke u mohuar në këtë mënyrë atyre garancitë e Kodit të Punës. Këto marrëdhënie informale i privojnë profesionistët e medias nga përfitimet e sigurimeve shoqërore, siguracionet, dhe të drejtat e tjera themelore të punës, duke i bërë kështu edhe më të cenueshëm ndaj paqëndrueshmërisë ekonomike dhe ndaj shfrytëzimit. Përveç kësaj, një informalitet i tillë shpesh ka një sërë shkeljesh, si imponimi i njëanshëm i kushteve të kontratës nga punëdhënësi pa konsultim me punëmarrësin, mosnjohja e viteve të punës të punonjësve dhe deklaratat e rreme të pagave.⁶³ Këto praktika ilustrohen me rastet kur gazetarët marrin një pjesë të pagës në dorë,

60 Siç evidentohet në katër raporte të njëpasnjëshme nga Rrjeti SafeJournalists për Indeksin e Sigurisë së Gazetarëve [2020](#), [2021](#), [2022](#), [2023](#).

61 [Kodi i Punës](#)

62 Treguesit e lirisë së Medias dhe i Sigurisë së Gazetarëve në Shqipëri [2020](#), [2021](#), [2022](#) dhe [2023](#).

63 Komiteti Shqiptar i Helsinkit. (2024, qershor). [Barometri i të drejtave të njeriut në Shqipëri, 2023](#). (Tiranë, KSHH).

duke ndikuar drejtpërdrejt tek e drejta për përfitime sociale, siç është leja e lindjes. Si rezultat, gratë gazetare preken më shumë, ku përfitimet e mbrojtjes sociale bien ndjeshëm për shkak të pagave të deklaruara artificialisht të ulëta.⁶⁴

Zbatimi i politikave kundër ngacmimit në vendin e punës mbetet ndjeshëm i kufizuar në media. Edhe pse punëdhënësit janë të detyruar ligjërisht të parandalojnë në mënyrë aktive ngacmimin në vendin e punës dhe të afishojnë publikisht politikat kundër ngacmimit, zbatimi në praktikë i këtyre kërkesave ligjore është shpesh i paqëndrueshëm dhe i pamjaftueshëm.⁶⁵ Mangësitë me zbatimin e ligjit përkeqësohen edhe më shumë nga mungesa e marrëveshjeve kolektive ose e sindikatave funksionale të afta për të përfaqësuar të drejtat e punonjësve të medias. Pa mbrojtje sindikale dhe marrëveshje kolektive, gazetarët janë më ngurrues të shprehin ankesa ose të raportojnë ngacmimin dhe diskriminimin në vendin e punës, nga frika e hakmarrjes së punëdhënësit ose rrezikut të humbjes së punës.⁶⁶ Rrjedhimisht, gratë gazetare në Shqipëri e gjejnë veten në një mjedis të pasigurt pune të karakterizuar nga informaliteti, përgjigje të pamjaftueshme institucionale dhe llogaridhënie e kufizuar - faktorë që dëmtojnë ndjeshëm sigurinë e tyre në vendin e punës, stabilitetin ekonomik dhe mirëqenien profesionale. Niveli i ulët i sindikalizimit të gazetarëve i lë ata edhe më të cenueshëm.

— 4.7 NDIHMMA LIGJORE DHE MBËSHTETJA INSTITUCIONALE

Në Shqipëri, institucionet shtetërore ofrojnë ndihmë ligjore falas për viktimat e dhunës në familje, ngacmimit seksual dhe trafikimit të qenieve njerëzore, siç përcaktohet në nenin 11 të Ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".⁶⁷ Përfituesit sipas këtij ligji janë individët me të ardhura të pakta, personat me aftësi të kufizuara, të miturit, individët pjesë e skemave të mbrojtjes sociale dhe viktimat e diskriminimit të verifikuara nga autoritetet kompetente. Megjithatë, këto kriterë të bazuara në të ardhura dhe cenueshmëritë rrezikojnë të përjashtojnë gratë gazetare, statusi profesional dhe ekonomik i të cilave mund të mos përputhet qartë me kategoritë e paracaktuara, pavarësisht se përballja e tyre specifike ndaj dhunës lidhet drejtpërsëdrejti me aktivitetet e tyre profesionale.⁶⁸ Ky hendek i lë gazetarët tejte të cenueshëm ndaj sfidave ligjore, përfshirë këtu edhe Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP), të cilat shpesh përdoren për t'i trembur dhe heshtur ata.⁶⁹

Është e nevojshme të ndërmerren reforma ligjore për të përafruar legjislacionin shqiptar me Direktivën e BE-së

64 Komiteti Shqiptar i Helsinkit. (2024, dhjetor). [Barometri Kombëtar i Lirisë së Medias në Shqipëri 2022-2023](#). (Tiranë, KSHH).

65 Komiteti Shqiptar i Helsinkit. (2024, dhjetor). [Barometri Kombëtar i Lirisë së Medias në Shqipëri 2022-2023](#). (Tiranë, KSHH).

66 Treguesit e lirisë së Medias dhe i Sigurisë së Gazetarëve në Shqipëri [2020](#), [2021](#), [2022](#) dhe [2023](#).

67 [Ligji "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti"](#).

68 Siç evidentohet në katër raporte të njëpasnjëshme nga Rrjeti SafeJournalists për Indeks in e Sigurisë së Gazetarëve [2020](#), [2021](#), [2022](#), [2023](#).

69 Kusari, F. (2024, dhjetor). [Vlerësim bazë rajonal i nevojave ligjore dhe politike për zbatimin e standardeve të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian për luftën kundër përdorimit të SLAPP-ve: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia](#). Divizioni i Këshillit të Evropës për Bashkëpunim për Lirinë e Shprehjes.

Anti-SLAPP dhe Rekomandimin e Këshillit të Evropës.⁷⁰ Edhe pse disa organizata joqeveritare (OJQ) ofrojnë ndihmë ligjore plotësuese, mbetet një boshllëk i madh për sa i përket mbështetjes së posaçme ligjore qartësisht të përshtatur ndaj dobësive dhe rreziqeve unike me të cilat përballen gratë gazetare. Si pasojë, këto të fundit mbeten pa mbështetje institucionale të përshtatur mjaftueshëm për to, të arritshme dhe gjithëpërfshirëse, duke kufizuar aftësinë e tyre për të kërkuar mbrojtje dhe mjete efikase kur përballen me kërcënime ose dhunë për shkak të profesionit që ushtrojnë.

— 4.8

LEGJISLACIONI PËR MEDIAT AUDIOVIZIVE

Paragrafi 36/1 i nenit 3 të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizuale", i ndryshuar me Ligjin nr. 30/2023,⁷¹ e përcakton seksizmin në mediat audiovizuale si: *"çdo akt, veprim, gjest, përfaqësim vizual, fjalë të shkruara ose të thëna në median audiovizive, praktika ose sjellje të bazuara në idenë se një person ose grup personash është inferior për shkak të gjinisë, që ndodh në sferën publike ose private, online ose offline, me efekt dhe qëllim dhunimin e dinjitetit të njeriut, të drejtat dhe liritë themelore të një personi apo grupi personash, shtetas shqiptarë, të huaj apo pa shtetësi, që rezulton në dëm ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose socio-ekonomike ndaj një personi apo grupi personash, shtetas shqiptarë, të huaj apo pa shtetësi ose që krijon apo ushqen krijimin e një mjedisi që ngjall frikë, armiqësor, degradues, fyes ose poshtërues, ose ushqen apo synon ruajtjen dhe përforcimin e stereotipave gjinorë."* Po ashtu, neni 4 i këtij ligji parashikon se parimet e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit janë të garantuara, përfshirë ndalimin e seksizmit në media dhe përfaqësimin gjinor në median audiovizuale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

70 Marku, E., & Tuzi, B. (2024, tetor). [Korniza ligjore për harmonizimin e direktivës anti-SLAPP \(paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike\)](#) (dokument pune). Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCIDEV).

71 [Ligji për mediat audiovizive](#)

V

Siguria e grave gazetare 2021—2024

Në këtë kapitull bëhet një analizë e situatës së sigurisë së grave gazetare në Shqipëri nga viti 2021 deri në vitin 2024, duke nxjerrë në pah tendencat dhe format kryesore të identifikuara përmes rasteve të dokumentuara nga Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt (SJN). Në të shqyrtohen format kryesore të kërcënimeve, ngacmimeve dhe kanosjeve me të cilat përballen gratë në gazetari, me fokus të veçantë në përhapjen e ngacmimeve online, abuzimit verbal dhe fushatave të shpifjes si shqetësime më të zakonshme. Në analizë përfshihen të dhëna statistikore, një kategorizim tematik i llojeve të sulmeve dhe hollësi të rasteve studimore ku ilustrohen modele specifike të kanosjes dhe presionit me bazë gjinore, duke bërë të mundur kështu të kuptohet plotësisht mjedisi ku veprojnë gratë gazetare në Shqipëri.

— 5.1

NJOFTIMET E SJN PËR SULMET KUNDËR GRAVE GAZETARE 2021-2024

Nga viti 2021 deri në vitin 2024, gratë gazetare në Shqipëri përjetuan një valë kërcënimesh që ishin kryesisht në formën e kanosjeve, presioneve, ngacmimeve digjitale dhe abuzimeve verbale. Edhe pse dhuna fizike ishte përgjithësisht e kufizuar dhe kanosjet serioze për jetën mbetën të rralla, incidentet e raportuara tregojnë qartë një mjedis armiqësor të vazhdueshëm të karakterizuar nga përpjekjet për të frikësuar dhe shtypur gazetarinë kritike, ku preken veçanërisht gratë gazetare që raportojnë për tema të ndjeshme politike ose që lidhen me korrupsionin. Gjatë kësaj periudhe, në bazën e të dhënave të Rrjetit të Gazetarëve të Sigurt janë regjistruar zyrtarisht 33 raste që kishin të bënin me gratë gazetare.

Tabela 3: Rastet e kërcënimeve dhe sulmeve kundër gazetarëve në Shqipëri (2021–2024)

Kategoritë	Gjinia	2021	2022	2023	2024	Gjithsej
Kanosje dhe ngacmime jo-fizike	Burra	2	4	3	10	19
	Gra	0	1	2	10	13
Kërcënime kundër jetës dhe sigurisë fizike	Burra	0	1	1	3	5
	Gra	1	1	1	1	4
Sulme aktuale fizike ndaj gazetarëve	Burra	5	6	12	3	26
	Gra	4	3	7	2	16
Raste gjithsej (në vit)	Burra	7	11	16	16	50
	Gra	5	5	10	13	33

— 5.2 FORMAT E SIGURISË SË GRAVE GAZETARE

Gratë gazetare në Shqipëri përballen kryesisht me kërcënime, kanosje, presione dhe ngacmime digjitale dhe më pak situata serioze dhune fizike apo kanosje për jetën. Edhe pse incidentet fizike janë të rralla dhe të kufizuara, në to përfshihen si aktorët privatë ashtu edhe autoritetet shtetërore, duke nxjerrë në pah rreziqet e vazhdueshme për gratë gazetare që raportojnë për çështje të ndjeshme.

Ngacmimi online shfaqet si problemi më i përhapur dhe më urgjenti. Gratë gazetare shpesh përballen me fushata të organizuara shpifjesh që kanë një qëllim të qartë: minimin e besueshmërisë së tyre profesionale. SJN ka dokumentuar një trend në rritje të kërcënimeve online, të cilat dëmtojnë ndjeshëm reputacionin e gazetarëve dhe aftësinë e tyre për të raportuar lirisht, gjë që çon shpesh në vetë-censurë. Një konstatim i tillë është pothuajse në të njëjtën linjë me gjetjet e një sondazhi të kohëve të fundit, nga ku evidentohet se ngacmimi verbal është më i përhapuri (71.4%), i ndjekur nga ngacmimi online (35.7%), kërcënimet fizike (21.4%) dhe ngacmimi seksual (14.3%).⁷² Ndikimi i këtyre kërcënimeve është i konsiderueshëm: 28.6% e grave gazetare raportuan se puna e tyre u ndikua ndjeshëm, dhe 42.9% thanë se ndikimi i tyre ishte në nivele të moderuara. Alarmuese është se 17.6% deklaruan se ishin të detyruara të ndryshonin, shtynin ose braktisnin raportimin e tyre pikërisht për shkak të presioneve me bazë gjinore.⁷³ Ky efekt frenues ndikon më së shumti te gazetarët televizivë dhe ata investigativë, prania publike dhe tematika e të cilëve i bëjnë ata shënjestër të mirëfilltë kur mbulojnë tema të ndjeshme dhe të debatueshme.

Një problem madhor për gratë gazetare që përballen me ngacmim në vendin e punës është mungesa e mbështetjes së mjaftueshme nga institucioni ku punojnë. Pothuajse gjysma e të anketuarave raportuan se kanë marrë pak ose aspak mbështetje nga media ku punojnë (29.4% nuk kanë marrë mbështetje dhe 19.1% mbështetje të pamjaftueshme). Si pasojë, shumë

72 Canga, E., Xhaferaj, O., et al. (2024). [Raporti Vjetor 2024: Ndjekja e Progresit të Shqipërisë në Lirinë e Medias dhe Sigurinë Gazetare në Përputhje me Standardet e BE-së](#). BIRN Albania dhe SCiDEV.

73 Canga, E., Xhaferaj, O., et al. (2024). [Raporti Vjetor 2024: Ndjekja e Progresit të Shqipërisë në Lirinë e Medias dhe Sigurinë Gazetare në Përputhje me Standardet e BE-së](#). BIRN Albania dhe SCiDEV.

gazetarë kanë përdorur strategji vetëmbrojtëse: 41.2% kanë rritur masat e sigurisë personale, 38.2% kanë shmangur detyra të caktuara dhe 11.8% kanë kërkuar mbështetjeje tek rrjetet.⁷⁴

Kërcënimi ligjor, përmes padive dhe kërcënimeve për veprime ligjore, po përdoret përherë e më shumë për t'i mbyllur zërin gazetarisë investigative. Gazetarët që përballen me kërcënime të tilla ligjore raportojnë rritje të ankthit dhe shpesh përdorin vetë-censurë. Megjithatë, nuk ka ende të dhëna specifike lidhur paditë që janë bërë kundër grave gazetare. Përveç kësaj, abuzimi verbal dhe fushatat e shpifjes të orkestruara nga politikanë, pronarë të mediave dhe figura publike me influencë i përkeqësojnë edhe më shumë këto presione. Në sulme të tilla shpesh përdoret fjalor fyes me baze gjinore ose akuza morale, duke synuar në mënyrë të qartë dëmtimin e reputacionit profesional të grave gazetare dhe pengimin e raportimit kritik të tyre. Denoncimet e motivuara politikisht nga zyrtarë të lartë kontribuojnë në një mjedis që i normalizon ato, gjë që nxit përhapjen e armiqësisë dhe dëmton më tej klimën e përgjithshme të sigurisë për gratë gazetare në vend.

Ngacmimet online me bazë gjinore, sulmet verbale dhe debati anti-media që mbizotëron në vend sjellin pasoja serioze për sigurinë e grave gazetare në Shqipëri, duke dëmtuar aftësinë e tyre për të marrë pjesë aktive dhe të sigurt në debatin publik. Ky mjedis armiqësor nxit vetë-censurën dhe i dekurajon gratë të angazhohen në gazetari kritike ose investigative për shkak të frikës nga pasojat, duke kufizuar edhe më shumë lirinë e tyre profesionale dhe ecurinë në karrierë. Përveç kësaj, shumë incidente nuk raportohen për shkak të frikës nga hakmarrja, mbrojtjes së pamjaftueshme institucionale ose normalizimit të armiqësisë ndaj gazetareve gra, duke sjellë kështu përhapjen e një kulture heshtjeje dhe pandëshkueshmërie.

Duhet evidentuar, po ashtu, se mediat e mëdha vazhdojnë të pasqyrojnë pabarazi të mëdha gjinore, ku emisionet politike me audiencë të madhe dhe panelet e ekspertëve dominohen nga meshkujt, ndërkohë që përfaqësimi i grave ulet kryesisht në role stereotipike brenda programeve argëtuese, modës dhe 'reality show'. Ky përfaqësim i pabarabartë jo vetëm që minon besueshmërinë dhe autoritetin e grave gazetare, por përforcon edhe më tej perceptimet publike që minimizojnë kontributet e tyre dhe përkeqësojnë ndjeshmërinë e tyre ndaj ngacmimeve dhe kërcënimeve që kanë në shënjestër ato.

74 Canga, E., Xhaferaj, O., et al. (2024). [Raporti Vjetor 2024: Ndjekja e Progresit të Shqipërisë në Lirinë e Medias dhe Sigurinë Gazetare në Përputhje me Standardet e BE-së](#). BIRN Albania dhe SCiDEV.

VI

Përvojat dhe perspektivat e grave gazetare

Në këtë kapitull jepen analiza cilësore nga intervistat e thelluara dhe diskutimet në fokus grupe me gra gazetare, eksperte dhe redaktore, për të nxjerrë në pah përvojat e tyre me forma të ndryshme të ngacmimit dhe dhunës së hasur në punën e tyre profesionale. Në të shqyrtohet se si kanë ndikuar në punën e përditshme, zgjedhjet profesionale dhe jetën personale të grave gazetare kërcënimet e formave të ndryshme, si ngacmimi digjital, sulmet verbale, kanosja me bazë gjinor dhe abuzimi me paditë ligjore. Në këtë analizë jepen dëshmi të drejtpërdrejta nga gratë gazetare, të cilat hedhin dritë mbi kulturën mbizotëruese të frikësimit, mungesën e mekanizmave të mjaftueshëm mbështetës institucionalë dhe arsyet pse shumë gra gazetare zgjedhin të mos raportojnë incidente të tilla. Kjo analizë ndihmon në evidentimin e sfidave të dukshme dhe të fshehura me të cilat përballen ato, duke theksuar nevojën urgjente për përgjigje sistematike institucionale dhe forcimin e masave mbrojtëse në Shqipëri.

— 6.1 KËRCËNIMET DHE KANOSJET E SHPESHTA NË VENDIN E PUNËS

Në Shqipëri gratë gazetare përballen me një sërë kërcënimesh fizike dhe verbale si rutinë e punës së tyre. Disa të intervistuarat e përshkruan ngacmimin si një dukuri pothuajse të përditshme gjatë raportimit në terren. *"Puna në gazetari, veçanërisht si grua, bëhet edhe më e vështirë... Është diçka me të cilën përballlet pothuajse çdo ditë një gazetare... sulmohesh në rrugë me fjalë dhe gjuhë të pisët kur dikujt nuk i pëlqen puna që bën"*, shpjegoi një gazetare.⁷⁵ Këto përballje mund të përshkallëzohen gjatë ngjarjeve të tensionuara, siç janë protestat ose situatat e konfliktit, ku gratë gazetare janë *"më të ekspozuara ndaj dhunës fizike"*. Kërcënimet shpesh vijnë nga individë që janë kundër një raportimi investigativ ose mbulimi të pafavorshëm, duke filluar nga figurat publike deri te qytetarët e zakonshëm që mund të ndihen se janë trajtuar në mënyrë të padrejtë nga puna e gazetares. Në redaksi, kërcënimet e drejtpërdrejta janë më pak të zakonshme, por pasiguria

75 Intervistë me gazetare

e vendit të punës ndonjëherë përdoret si levë. Siç u vu në dukje nga një gazetarë, nëse ngacmimi ndodh në vendin e punës, *"arsyetimi i vetëm është 'pushim nga puna'".*⁷⁶

Këto sulme intensifikohen kur gazetarët trajtojnë çështje të ndjeshme. Sipas një përfaqësuesi të shoqatës së medias, kërcënimet kanë tendencë të përshkallëzohen *"në periudha tensioni politik ose kur gazetarët mbulojnë tema të ndjeshme si korrupsioni ose abuzimi me pushtetin"*⁷⁷. Hetimet e profilit të lartë shpesh nxisin presione nga aktorë të fuqishëm, duke krijuar një atmosferë frike. Një gazetarë investigative tregoi se si raportimi i saj për shkeljet e qeverisë çoi në hakmarrje që kishin si objekt familjen e saj: *"Profesioni im si gazetarë ndikoi tek anëtarët e familjes... Një ministër... u përplas me motrën time, duke më kërcënuar në profesionin tim. Përndjekja ndaj motrës sime zgjati dy muaj... të cilës në shkelje flagrante të ligjit iu kërkua... të linte punën"*⁷⁸, të gjitha si hakmarrje për punën e gazetares. Raste të tilla nënvizojnë se si kërcënimet mund të shkojnë përtej një gazetareje, duke i vënë anëtarët e familjes së saj në rrezik në tentativa për ta detyruar atë dhe gazetaret e tjera të heshtin. Ndikimi psikologjik është i rëndë – frika për sigurinë personale dhe të dashurit çojnë në stres, ankth dhe ndjenjë të vazhdueshme cenueshmërie. Disa gra gazetarë tërhiqen krejtësisht nga temat investigative për të shmangur provokimin e sulmeve të tjera, duke ilustruar se si kërcënimet e vazhdueshme çojnë në vetë-censurë dhe minojnë raportimin kritik.

Të dhënat sasiore përforcojnë realitetin e këtij mjedisi armiqësor. Një raport i përbashkët i kohëve të fundit për lirinë e medias në Shqipëri nxjerr në pah *"kërcënimet dhe kanosjet në rritje"* kundër gazetarëve, duke vënë në dukje se ata shpesh bëhen shënjestër e ngacmimeve dhe presioneve ligjore, të cilat *"kontribuojnë në vetë-censurë dhe pasiguri"* në profesion.⁷⁹ Gratë gazetarë, në veçanti, përballen me *"më shumë rreziqe, si sulme verbale, fushata shpifjesh dhe ngacmime online, të cilat ndikojnë kryesisht në aftësinë e tyre për të punuar të sigurt dhe për të marrë pjesë në debatin publik"*.⁸⁰ Kanosja fizike dhe kërcënimet e drejtpërdrejta, nga fjalët kërcënuese në rrugë deri te përpjekjet e zyrtarëve për të ndëshkuar zërat kritikë, janë një model i përsëritur në përvojat e përjetuara nga gratë gazetarë. Këto incidente nxjerrin në pah *mangësitë institucionale* për mbrojtjen e gazetarëve: shumë autorë nuk ndiqen penalisht, duke nxitur kështu vazhdimin e agresioneve. Natyra rutinë e një ngacmimi të tillë tregon një klimë ku presioni ndaj grave gazetarëve shpesh pritet të ndodhë, por nuk dekurajohet mjaftueshëm.

76 Intervistë me gazetarë

77 Intervistë me gazetarë

78 Intervistë me gazetarë

79 Canga, E., Xhaferaj, O., et al. (2024). [Raporti Vjetor 2024: Ndjekja e Progresit të Shqipërisë në Lirinë e Medias dhe Sigurinë Gazetare në Përputhje me Standardet e BE-së](#). BIRN Albania dhe SCiDEV.

80 Canga, E., Xhaferaj, O., et al. (2024). [Raporti Vjetor 2024: Ndjekja e Progresit të Shqipërisë në Lirinë e Medias dhe Sigurinë Gazetare në Përputhje me Standardet e BE-së](#). BIRN Albania dhe SCiDEV.

— 6.2

NGACMIMET ONLINE DHE FUSHATAT E SHPIFJES

Abuzimi online shfaqet si një nga kërcënimet më të përhapura dhe të dëmshme me të cilat përballen gratë gazetare. Në studime të ndryshme konstatohet se gratë dhe veçanërisht gazetaret në Ballkanin Perëndimor “përballen me abuzim online çdo ditë” dhe Shqipëria nuk bën përjashtim në këtë drejtim.⁸¹ Pothuajse në çdo intervistë u përmendën platformat online, si komentet në Facebook, mesazhet anonime, forumet e portaleve të lajmeve, etj., si vendi kryesor ku bëhen sulmet. *“Kërcënimet... vijnë nga jashtë redaksisë. Më të shpeshtat janë ato që bëhen në rrjetet sociale”*, shpjegoi një gazetare, duke shtuar se ballafaqimet e drejtpërdrejta, ballë për ballë, janë bërë më pak të zakonshme sesa vërshimi i abuzimeve online që lidhen me raportimin e gazetares.⁸² Një tjetër e intervistuar i përshkroi mediat sociale si *“një armë e fortë dhe e pakontrollueshme”* që përdoret nga ata që janë të zemëruar me punën e gazetarëve.

Anonimiteti dhe shtrirja e gjerë e internetit bëjnë të mundur një valë të pandërprerë mesazhesh shpifëse ose agresive që synojnë të diskreditojnë gratë gazetare. Të intervistuarat raportuan se kanë përjetuar *“kërcënime të vazhdueshme nga individë anonimë”* në internet, shpesh në hakmarrje për mbulimin e kronikave të ndjeshme.⁸³ Këto kërcënime digjitale janë të formave të ndryshme, si fyerjet dhe denigrim i karakterit deri te kërcënimet e qarta për përdhunim apo vdekje, madje edhe kërcënimet kundër familjeve të tyre si mjet për t’i heshtur ato.⁸⁴ Volumi dhe shpeshtësia e abuzimeve online krijojnë një atmosferë të vazhdueshme armiqësie. *“Pothuajse çdo herë që publikoj një kronikë të ndjeshme, profilet që kam në mediat sociale më mbushen me komente të turpshme dhe me mesazhe private që më sulmojnë si grua”*⁸⁵, tha një pjesëmarrëse në fokus grup.

Gazetaret dhe gratë që shërbejnë si aktiviste dhe mbikëqyrëse të çështjeve publike në përgjithësi bien shpesh pre e fyrejeve seksiste, talljeve për pamjen e tyre të jashtme dhe sulmeve për jetën personale. Një abuzim i tillë zakonisht vjen formën e *“fyrejeve dhe poshtërimit seksist bazuar në pamjen fizike, kërcënimeve për përdhunim dhe sulmeve të tjera me bazë gjinore, të cilat nuk përjetojnë nga gazetarët meshkuj”*.⁸⁶ Gratë gazetare në Shqipëri e konfirmojnë këtë tendencë, duke vënë në dukje se ato *“shpesh vihen në shënjestër për paraqitjen dhe pamjen e jashtme përmes gjuhës seksiste, gjuhës së urrejtjes dhe komenteve përçmuese”*⁸⁷, dhe u bëhen komente mizogjine dhe të seksualizuara në mediat sociale me

81 DCAF. (2021). [Dhuna kibernetike ndaj grave dhe vajzave në Ballkanin Perëndimor: Studime të përzgjedhura rastesh dhe një qasje ndaj qeverisjes së sigurisë kibernetike](#). Geneva Centre for Security Sector Governance (DCAF). Reçi, M., & Kelmendi, S. (2023). [Liria për të mbrojtur të drejtat në hapësirat online: Sfidat për mbrojtësit e të drejtave të njeriut të grave në Shqipëri](#), në Studime rastesh mbi Gjininë dhe Sigurinë Kibernetike në Ballkanin Perëndimor, redaktuar nga E. Bavčić & K. Storr, Eds. (DCAF – Geneva Centre for Security Sector Governance)

82 Gazetare në fokus grup

83 Gazetare në fokus grup

84 Intervistë me gazetare

85 Gazetare në fokus grup

86 Bogdani, N., (2023). [Gratë aktivistet në Shqipëri përballen me një valë abuzimesh online](#). Balkan Insight.

87 Gazetare në fokus grup

një shpeshtësi shqetësuese. Një redaktore bëri një përshkrim të faktit që komentuesit online jo vetëm që sulmojnë punën e një gazetares, por edhe postojnë emoji ose komente të papërshtatshme rreth *"fizikut [ose] veshjes së saj"*, shpesh në përpjekje për të minuar besueshmërinë e saj duke e lidhur atë me reputacionin e punëdhënësit ose pronarit të saj.⁸⁸ Ndikimi psikologjik i këtij ngacmimi të pamëshirshëm, që shfaqet në formën e ankthit, frikës, apo poshtërimit, ishte një temë që u përsërit si në intervista ashtu edhe në fokus grupe.

Ashtu si në botën fizike, bota digjitale paraqet rreziqe të mëdha për gazetarët që raportojnë për tema të ndjeshme ose që ngjallin debat, në mënyrë të veçantë për ata gazetarë që u kërkojnë llogari personazheve të fuqishme, dhe ata që janë aktivisht të angazhuar në raportimin e shkeljeve ose mbrojtjen e të drejtave të njeriut, veçanërisht nëse janë të pranishëm vazhdimisht në platformat digjitale. Këta gazetarë shpesh bëhen shënjestra të ngacmimeve intensive online dhe fushatave të shpifjes për shkak të publicitetit dhe ndikimit të punës së tyre. Siç u vu në dukje nga një redaktore, *"Gazetarët që hetojnë korrupsionin ose denoncojnë aferat e zyrtarëve publikë përballen me më shumë presione - është pikërisht guximi dhe fama e tyre online që shkakton sulme të intensifikuara."*⁸⁹ Situata përkeqësohet më tej për gazetarët e pavarur, ata që punojnë në media të vogla lokale ose media online ose ata pa kontratë të përhershme dhe gazetarët nga prejardhje nga grupe të marginalizuara që përballen me dobësi të ndryshme për shkak të identitetit të tyre. Shpesh këta gazetarë nuk kanë mbështetje të mjaftueshme institucionale apo edhe nga kolegët, duke e përkeqësuar edhe më shumë identitetin e tyre dhe izolimin profesional që përjetojnë gjë që rrit më tej ekspozimin e tyre ndaj kërcënimeve të vazhdueshme digjitale.

Raportimet e rasteve të tilla tek autoritetet e zbatimit të ligjit është në nivele tepër të ulëta dhe reagimi i institucioneve kanë qenë i ngadaltë dhe i pamjaftueshëm. Shumë gra gazetares mendojnë se kërcënimet online nuk merren seriozisht nga autoritetet. Pavarësisht bollëkut të provave digjitale (si fotografim i ekranit, mesazhe, etj.), "në pjesën më të madhe të rasteve, autorët mbeten të paidentifikuar dhe të pandëshkuar, duke krijuar një ndjenjë pafuqie dhe pasigurie".⁹⁰ Gazetarët shpesh zgjedhin të mos i denoncojnë kërcënimet digjitale për shkak të besimit të pakët që kanë te përgjigja e institucioneve dhe frikës nga reagimi i mundshëm negativ. Një gazetare u shpreh kështu: "Nuk i denoncoj, sepse nuk mendoj se policia do t'i merrte seriozisht kërcënimet anonime në platformat online; ata zakonisht nuk merren fare me ankesa të tilla."⁹¹ Një tjetër shprehu frikën e hakmarrjes së mëvonshme ose dëmtimit të reputacionit, duke deklaruar: "Nëse ankohesh, rrezikon të etiketohesh si tepër e ndjeshme ose e dobët nga kolegët apo audienca."⁹²

88 Redaktore në fokus grup
89 Redaktore në fokus grup
90 Intervistë me gazetares
91 Intervistë me gazetares
92 Gazetare në fokus grup

Për më tepër, gazetarët e përshkruan ngacmimin online si mjaft të përhapur dhe të kthyer në diçka normale: *"Kërcënimet online tani janë pjesë e punës – më duket e kotë të raportosh çdo mesazh abuziv që marrim."*⁹³ Normalizimi i kanosjeve online dhe heshtja që i shoqëron ato kur bëhen kundër grave gazetare në Shqipëri janë thellësisht të rrënjësura në qëndrimet e mbarë shoqërisë dhe në normat patriarkale. Këto modele kulturore, të karakterizuara nga stereotipet e mbrujtura gjinore, nga mungesa e debatit publik me ndjeshmëri gjinore dhe nga njohuritë e mangëta për mediat dhe sistemet e informacionit formojnë një mjedis ku dhuna digjitale shpërfillet rregullisht si e parëndësishme ose pranohet si e pashmangshme.

Një oficer nga Departamenti i Krimit Kibernetik i Policisë së Shtetit konfirmoi se të gjitha denoncimet merren seriozisht, por theksoi se hetimi i këtyre rasteve varet shumë nga të dhënat që ofrojnë platformat online si Meta, të cilat kanë kërkesa të rrepta procedurale, si paraqitja e një urdhri gjykate, gjë që e ngadalëson ndjeshëm procesin. Ai u shpreh: *"Vetëm në raste emergjence kompanitë mund të ofrojnë të dhëna brenda 24 orëve, por vitet e fundit, asnjë rast i denoncuar për dhunë online ndaj gazetarëve, përfshirë gratë gazetare, nuk është klasifikuar si emergjent."*⁹⁴

Një tjetër shqetësim madhor është se gratë gazetare dhe aktivistet që angazhohen në sferën publike në Shqipëri kanë aftësi të dobëta lidhur me sigurinë kibernetike dhe njohuritë informatike, duke dëmtuar seriozisht mundësitë e tyre për t'iu përgjigjur me efektivitet kërcënimeve online. Ja si e shpjegon këtë gjë një gazetare: *"Ne dimë shumë pak për sigurinë digjitale. Dimë shumë pak si të mbrojmë llogaritë në mediat sociale ose privatësinë online. Ndonjëherë, as nuk e kuptojmë një kërcënim deri kur ai përshkallëzohet."*⁹⁵ Shpesh, gratë gazetare kanë tendencë të nënvlerësojnë seriozitetin dhe pasojat e mundshme në jetën reale të ngacmimeve online, gjë që rrit më tej cenueshmërinë e tyre.⁹⁶

Ky problem përkeqësohet edhe më shumë nga mungesa e ndërgjegjësimit rreth mekanizmave të mbrojtjes institucionale në dispozicion të gazetarëve. Një pjesëmarrëse e pranoi këtë mangësi, duke thënë: *"Të them të drejtën as nuk di se cilit institucion t'i drejtohem nëse do të më kërcënonin seriozisht online. Askush nuk na ka folur ndonjëherë për mbrojtjet që duhet të përfitojmë."*⁹⁷ Ky kombinim i përgatitjes së pamjaftueshme digjitale dhe ndërgjegjësimit të dobët institucional i bën edhe më serioze rreziqet dhe bën që niveli i denoncimeve të kërcënimeve online të jetë tepër i ulët.

Për më tepër, edhe pse disa nisma synojnë të mbrojnë të drejtat e gazetarëve, shoqatat dhe sindikatat e gazetarëve profesionistë mbeten të fragmentuara. Ato vuajnë nga

93 Intervistë me gazetare

94 Përmbledhja e takimit konsultativ me gazetarët dhe Policinë e Shtetit gjendet [këtu](#).

95 Intervistë me gazetare

96 Reçi, M., & Kelmendi, S. (2023), [Liria për të mbrojtur të drejtat në hapësirat online: Sfidat për mbrojtëset e të drejtave të njeriut të grave në Shqipëri, në Studime rastesh mbi Gjininë dhe Sigurinë Kibernetike në Ballkanin Perëndimor](#), redaktuar nga E. Bavčić & K. Storr, Eds. (DCAF – Geneva Centre for Security Sector Governance).

97 Gazetare në fokus grup

burimet e pakta dhe përgjithësisht u mungon efikasiteti në ndihmën që u japin gazetarëve që përballen me kërcënime ose ngacmime. Mbështetja nga këto shoqata priret të jetë fillimisht në formën e deklaratave dhe zakonisht kufizohet vetëm dhënien e njoftimeve apo deklaratave publike. Rrallëherë ofrojnë ndihmë të konsiderueshme dhe të prekshme, si këshillimi psikologjik, mbështetja emocionale, ndihma ligjore apo mbështetja financiare. Ja si u shpreh një gazetar: *"I vlerësojmë deklaratat që dënojnë sulmet, por në realitet, na duhet mbështetje konkrete."*⁹⁸

*Edhe pse deklaratat publike dhe shprehja e mbështetjes nga shoqatat dhe rrjetet e gazetarëve janë të vlefshme dhe të dobishme në rritjen e ndërgjegjësimit rreth kërcënimeve me të cilat përballen gratë gazetare, mbetja vetëm në nivel deklaratash nuk mjafton. Gratë gazetare theksojnë nevojën urgjente për mbështetje të prekshme teknike, psikologjike dhe ligjore për t'u përballur me kërcënimet dhe ngacmimet dhe për t'u përgjigjur sa më mirë atyre. Në mungesë të një mbështetjeje dhe ndihme të tillë, gazetarët vazhdojnë të hasin probleme në hapësirën digjitale. Nga ana tjetër, shoqëria civile dhe organizatat monitoruese të mediave po shtojnë përpjekjet duke ofruar trajnime për sigurinë kibernetike me fokus të veçantë aktivistët, gazetarët e rinj, gratë gazetare dhe mediat lokale që vuajnë nga pamjaftueshmëria e burimeve.*⁹⁹

— 6.3 NGACMIMI SEKSUAL SI SHQETËSIM I FSHEHUR, POR I VAZHDUESHËM

Përveç kërcënimeve të drejtpërdrejta dhe ngacmimeve online, gazetarët në Shqipëri raportojnë se kanë përjetuar sjellje që perceptohen si ngacmim seksual. Ndonëse provat e pakundërshtueshme dhe denoncimet zyrtare mbeten të pakta, gjatë intervistave dhe diskutimeve në fokus grupe shumë gazetare treguan se ato ose kanë hasur personalisht ose janë në dijeni të kolegeve që janë përballur me sjellje të papërshtatshme ose ngacmime të padëshiruara. Këto incidente ndodhin si në redaksi ashtu edhe gjatë raportimit në terren, ku të intervistuarat deklarojnë se "ngacmimi seksual dhe presionet psikologjike janë për fat të keq ndër çështjet më të diskutuara", edhe pse diskutime të tilla zakonisht bëhen në mënyrë informale dhe private.

Pjesëmarrëset në diskutime përshkruan situata ku ngacmimi ose vëmendja e papërshtatshme vinte nga kolegët, eprorët, burimet ose të intervistuarit, duke theksuar natyrën delikate, por shqetësuese të incidenteve të tilla. Një gazetar theksoi me kujdes: *"Disa kolege kanë lënë të kuptohet se janë përballur me situata të pakëndshme, veçanërisht kur bashkëveprojnë me personazhe të fuqishme ose në zyrat e redaksisë. Por është e vështirë të flasësh hapur për këto gjëra."* Duke pasur parasysh dinamikën e pushtetit që shpesh është në lojë - kryesisht burra

98 Gazetare në fokus grup

99 Shih trajnimet e ofruara nga BIRN Albania, SCiDEV, IDM, CRD.

të rëndësishëm që bashkëveprojnë me gazetare më të reja në moshë- shumë gra mendojnë se shprehja e shqetësimeve të tilla hapur mund të rrezikojë mundësitë për të bërë karrierë ose mund të dëmtojë marrëdhëniet profesionale.

Ngurrimi për të denoncuar ose diskutuar hapur për këto probleme duket se lidhet jo vetëm me frikën e pasojave në profesion, por edhe me qëndrimet shoqërore që tentojnë të minimizojnë ose shpërfillin format e dhunës dhe kanosjet me bazë gjinore.¹⁰⁰ Një gazetare me vite në profesion shpjegon: *"Ekziston një kulturë heshtjeje, pjesërisht sepse gratë kanë frikë se mos stigmatizohen ose etiketohen si problematike. Është situatë delikate."* Në fakt, për shkak të stigmës shoqërore dhe mungesës së rregulloreve të brendshëm të përcaktuar qartë në organet e mediave, gratë gazetare shpesh përdorin forma shmangieje, duke zgjedhur të distancohen në heshtje nga ato detyra, individë ose mjedise ku ndihen të pasigurta ose të paretshme për punë.¹⁰¹ Ky reagim jo vetëm që pasqyron qëndrimin e gjerë shoqëror, por bëhet pa dashje pengesë për zhvillimin e tyre profesional dhe përforcon pabarazitë gjinore në sektorin e medias.

Mekanizmat mbështetës për gratë gazetare që përballen me ngacmim seksual mbeten të kufizuara. Siç e pranojnë vetë gratë redaktore, *"Mediat në vend rrallë kanë mekanizma mbështetës të shpallura zyrtarisht ose politika të qarta kundër ngacmimit seksual; ne nuk jemi edhe aq të përgatitur sa të trajtojmë me efikasitet çështje të tilla delikate."*¹⁰² Përveç kësaj, shoqatat dhe sindikatat e gazetarëve, që mund të ofrojnë këshilla dhe mbështetje, ose mungojnë ose nuk janë aspak efektive. Siç theksojnë ekspertet e medias, *"një problem i madh është mungesa e sindikatave... për të mbrojtur të drejtat e gazetarëve"* në Shqipëri. Ky hendek institucional po fillon të kuptohet. Nën presionin ndërkombëtar, përfshirë detyrimet nga Konventa e Stambollit për dhunën ndaj grave, autoritetet shqiptare kanë filluar të diskutojnë masat për të trajtuar ngacmimin në vendin e punës. Megjithatë, mekanizmat aktualë përqendrohen kryesisht tek dhuna në familje dhe përshkruhen si *"të fragmentuara, të pajisura në mënyrë të pamjaftueshme dhe të papërshtatura"* për kontekstin e mediave.¹⁰³ Si rezultat, gazetaret që përjetojnë ngacmim seksual qoftë në punë ose gjatë punës në terren kanë pak alternativa të posaçme për të gjetur zgjidhje. Kjo mungesë e mbështetjes institucionale - si nga mediat ashtu edhe nga autoritetet - bën që shumë incidente të mos raportohen dhe, rrjedhimisht, të mos gjejnë zgjidhje.

— 6.4 KËRCËNIMET LIGJORE KUNDËR GRAVE GAZETARE

Kërcënimet ligjore, veçanërisht paditë për shpifje, përbëjnë një nga forma më kryesore të presionit me të cilën përballen

100 Shih [Studimin për ngacmimet seksuale në vendin e punës në Shqipëri 2024](#).

101 Intervistë me eksperte të medias

102 Pjesëmarrëse në diskutimet në fokus grup

103 Pjesëmarrëse në diskutimet në fokus grup

gazetarët në Shqipëri, që shërben si instrument i fuqishëm për të heshtur zërat kritikë. Gratë gazetare shpesh bëhen shënjestër e padive të pabazuara për shpifje ose kërcënimeve për padi penale të iniciuara nga figura me influencë, si politikanë, elita biznesi ose bashkëpunëtorë të krimit të organizuar, kur kronikat e gazetareve trajtojnë korrupsionin, shkeljet ose abuzimin me pushtetin. Megjithatë, nuk ka të dhëna të ndara sipas gjinisë për të përcaktuar nëse gratë gazetare përballen me një numër më të lartë kërcënimesh ligjore ose padi SLAPP në krahasim me kolegët meshkuj. Të dhëna të tilla nuk janë të disponueshme, pasi ato nuk mblidhen ose analizohen në sistematikisht në këtë kontekst. Siç u theksua nga një gazetare, *"Jam përballur me kërcënime si padi për shpifje nga njerëz që ndihen të kërcënuar nga puna ime... dhe edhe nëse ata nuk e bëjnë padinë, kërcënimi është aty"*¹⁰⁴, duke theksuar se si këto padi bëhen kërcënim i drejtpërdrejtë dhe nxisin vetë-censurë. Një tjetër gazetare nënvizoi efektin frenues të kërcënimeve me padi: *"Vetëm të mendosh që dikush i fuqishëm mund të të padisë të bën të mendohesh dy herë para publikimit të materialeve të ndjeshme. Është si të kesh një kërcënim të vazhdueshëm që të varet mbi kokë."*¹⁰⁵

Klasifikimi i shpifjes si kundërvajtje penale sipas legjislacionit shqiptar¹⁰⁶, që dënohet me gjobë të rëndë, u jep më shumë fuqi njerëzve me influencë për të shfrytëzuar mekanizmat ligjorë kundër gazetarëve. Siç u theksua nga një ekspert ligjor, *"vetëm kërcënimi me padi penale për shpifje është shpesh i mjaftueshëm për të dekurajuar raportimin investigativ, veçanërisht për gratë që tashmë përballen me presione të tjera shoqërore."*¹⁰⁷ Ndikimi psikologjik, i shoqëruar me rreziqe financiare dhe profesionale, e bën edhe më të detyrueshëm vetë-censurën, gërryen pavarësinë e gazetarëve dhe përfundimisht minon të drejtën e publikut për debat të informuar.

Kohët e fundit janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të trajnuar gjyqtarët dhe prokurorët sipas standardeve ndërkombëtare për sigurinë e gazetarëve dhe masat kundër padive SLAPP, trajnime që konsiderohen si zhvillime pozitive,¹⁰⁸ por që gjithsesi mbeten ende me shumë mangësi. Angazhimi i qeverisë shqiptare,¹⁰⁹ në parim, për të forcuar mbrojtjen ligjore për gazetarët si pjesë e programit të saj të anëtarësimit në BE nuk është përkthyer ende në reforma konkrete ligjore. Aktualisht, legjislacionit shqiptar i mungojnë dispozita të posaçme kundër padive SLAPP në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, të tilla si pushimi i përshpejtuar i çështjes, afatet kohore të barrës së provës dhe kompensimi i kostove ligjore, gjë që i lë gazetarët të cenueshëm ndaj taktikave të stërzgjatjes së procedurave gjyqësore dhe frikësimeve.

104 Intervistë me gazetare

105 Intervistë me gazetare

106 Treguesit e nivelit të lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve në Shqipëri [2020](#), [2021](#), [2022](#) dhe [2023](#).

107 Intervistë me ekspert ligjor

108 Shih [Projektin PRO-FREX](#) të Këshillit të Evropës si shembull

109 [Tryezë e rrumbullakët e nivelit të lartë kundër padive SLAPP në Shqipëri, tetor 2024.](#)

Për të zbatuar me efektivitet direktivën e BE-së Anti-SLAPP¹¹⁰ dhe Rekomandimin e Këshillit të Evropës¹¹¹, nevojiten ndryshime të rëndësishme si në Kodin e Procedurës Civile ashtu edhe në Kodin Penal.¹¹² Ndryshimi i këtyre kodeve duhet të shoqërohet me tregues kryesorë për të identifikuar paditë SLAPP, pushimin menjëherë të padive, përfshirë këtu edhe afatet kohore të përcaktuara për barrën e provës, sigurinë e kostove procedurale, kompensimin e shpenzimeve ligjore dhe pezullimin e gjyqimit në raste qartësisht abuzive.¹¹³ Pa reforma gjithëpërfshirëse legjislative dhe procedurale që u ofrojnë mbrojtje të mirëfilltë gazetarëve nga paditë abuzive dhe që sigurojnë trajtim gjyqësor të shpejtë dhe të drejtë, këto presione ligjore do të vazhdojnë të gërryjnë lirinë e medias dhe rolin demokratik të gazetarisë në Shqipëri.

— 6.5 PRESIONET E BRENDSHME DHE VETE-CENSURA

Gratë gazetare në Shqipëri përjetojnë jo vetëm kërcënime të jashtme, por edhe censurë dhe presione të brendshme nga vetë mediat e tyre. Disa gazetare përshkruan raste ku kryeredaktorët i dekurajuan haptazi ose në mënyrë të tërthortë duke u thënë të mos bënin hetime për çështje të ndjeshme. Presionet nga jashtë që vijnë nga politika dhe biznesi e intensifikojnë më tej këtë dinamikë. Duke pasur parasysh se shumë media shqiptare varen financiarisht nga politika ose bizneset, gazetarët përballen me një trekëndësh presioni: nga drejtuesit e tyre, nga bizneset e reklamave dhe nga aktorë të fuqishëm. Një gazetare tregoi se ishte këshilluar haptazi nga një kryeredaktor që *"lërë këtë investigim për të mirën tënde"*,¹¹⁴ duke nxjerrë në pah një përpjekje të drejtpërdrejtë për të mbyllur raportimin e saj për një personazh me influencë, që përbënte një kërcënim të hapur. Një tjetër e intervistuar përshkroi një formë më delikate presioni, duke kujtuar situatat ku artikujt u hoqën pa zhurmë nga botimi pa dhënë asnjë shpjegim: *"Kam pasur disa artikuj që m'i kanë vlarë në minutën e fundit. Askush nuk thotë hapur pse, por është e qartë se ata po mbrojnë interesa të fuqishme."*¹¹⁵

Për më tepër, censura e brendshme shpesh nxitet nga interesat e pronarëve të mediave ose aktorëve me influencë. Siç shpjegoi një gazetare, *"shpesh detyrohemi të respektojmë linjat editoriale që i japin përparësi interesave të pronarit ose të grupit"*,¹¹⁶ duke çuar në vetë-censurë për tema që mund të turpërojnë ose shqetësojnë individë të fuqishëm të lidhur me drejtuesit ose pronarët e medias. Një gazetare tjetër theksoi dimensionin gjinor të këtij presioni: *"Si gazetare, të thuhet si me stil se të sfidosh figura me pushtet, qofshin*

110 [Direktiva e BE-së kundër padive SLAPP](#)

111 [Rekomandimi i Këshillit të Evropës mbi anti-SLAPP](#)

112 [Dokument pune: Korniza ligjore për harmonizimin e direktivës anti-SLAPP \(paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike\)](#)

113 [Vlerësimi bazë rajonal i nevojave legjislative dhe politike për zbatimin e standardeve të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian për luftën kundër përdorimit të SLAPP-ve, dhjetor 2024.](#)

114 Pjesëmarrëse në diskutimet në fokus grup

115 Intervistë me gazetare

116 Pjesëmarrëse në diskutimet në fokus grup

*politikanë, biznese reklamash apo miq të pronarit, thjesht nuk është puna jote. Mund të të rrezikojë vendin e punës."*¹¹⁷

Pasiguria ekonomike e intensifikon më tej vetë-censurën mes grave gazetares, të cilat shpesh punojnë me kontrata të pasigurta pune dhe kanë frikë se mos humbasin vendin e punës. Siç u vu në dukje nga një gazetare, *"Duke pasur parasysh sa të pasigurta janë kontratat tona, mendoj dy herë para se të shkruaj histori të ndjeshme. Nuk mund ta përballoj humbjen e punës për një artikull."*¹¹⁸ Kjo dobësi ekonomike shton një tjetër pengesë, duke i detyruar gazetarët të mos trajtojnë tema të rëndësishme ose të me interes publik.

Pasojat e këtyre presioneve janë të mëdha, duke ndikuar si te gazetarët ashtu edhe në debatin e gjerë publik. Kur gratë gazetarët censurohen ose detyrohen të vetë-censurohen, historitë e rëndësishme me interes të madh publik mbeten të papublikuara, duke minuar kështu rolin e rëndësishëm të medias si informues. Nga ana tjetër, një situatë e tillë i fuqizon edhe më shumë ata që ushtrojnë presion, duke përforcuar perceptimin se frikësimi mund të shtypë pa problem kronikat kritike. Ndonëse disa gazetarë vazhdojnë punën e tyre pavarësisht këtyre presioneve, të tjerë raportojnë se i lënë në sirtar artikujt investigativë ose tërhiqen plotësisht, duke gjykuar se rreziqet personale ose familjare janë tejet të papërballueshme. Gratë gazetares, në veçanti, janë më të ndjeshme ndaj sulmeve personale me bazë gjinore dhe fushatave të shpifjes, dhe shpesh ndihen të detyruara të vetë-censurohen për të shmangur intensifikimin e ngacmimeve. Siç tha një gazetare, *"pas kërcënimeve që marr, veçanërisht online, ndonjëherë e rimendoj publikimin e historive sensitive. Nuk ia vlen ta vë veten ose familjen time në ankth të vazhdueshëm"*.¹¹⁹ Një tjetër gazetare argumentoi se *"të jesh gazetare do të thotë të jesh e guximshme dhe guxosh pak më shumë, edhe kur përballesh me presione ose kërcënime, sepse nëse tërhiqemi, shoqëria humbet zërin e saj."*¹²⁰

Institucionalisht, politikat editoriale që mbrojnë pavarësinë e gazetarëve mbeten të pamjaftueshme, veçanërisht për nga perspektiva gjinore. Është e qartë se mungon një sistem i konsoliduar në mbrojtje të gazetarëve nga ndikimi i jashtëm ose censura e brendshme. Redaktorët pranojnë se mediat kanë dështuar në punën e tyre për të krijuar një sistem ku të ofrohet mbështetje e mirëfilltë për gratë gazetares që përballen me kërcënime dhe ngacmime. Një redaktore e pranoi hapur: *"E vërteta është se ne si media shpesh nuk i mbrojmë dot gazetarët tanë ashtu siç duhet, duke qenë se nuk kemi pothuajse asnjë sistem të vërtetë mbështetjeje dhe sigurisht nuk japim as ndihmë financiare apo ligjore kur gazetarët tanë përballen me sulme."*¹²¹

117 Pjesëmarrëse në diskutimet në fokus grup

118 Intervistë me gazetare

119 Intervistë me gazetare

120 Pjesëmarrëse në diskutimet në fokus grup

121 Redaktore pjesëmarrëse në diskutimet në fokus grup

Redaktorët theksuan edhe situatën e pasigurt ekonomike të mediave në Shqipëri gjë që dëmton rëndë aftësinë e tyre për t'iu përgjigjur me efikasitet kërcënimeve. Ja si u evidentua ky konstatim gjatë diskutimeve në fokus grupe: *"Mjedisi mediatik në vend është i brishtë dhe shumë i politizuar, gjë që e bën edhe më të vështirë mbrojtjen e gazetarëve, duke qenë se mediat shpesh e gjejnë veten të preokupuar kryesisht me probleme mbijetese."*¹²² Këto vështirësi ekonomike të mediave kontribuojnë drejtpërsëdrejti në një klimë ku presionet e vetë-censurës gjejnë një terren mjaft të përshtatshëm. Siç u vu në dukje nga një gazetarë, *"E njëjta gazetarë prodhon të tjera kronika kur punon për një media të pavarur të financuar nga OJQ-të krahasuar kur punon për një kanal të njohur televiziv"*¹²³, duke theksuar se si pavarësia editoriale kompromentohet ndjeshëm nga strukturat e pronësisë si dhe nga influencat dhe lidhjet politike. Ky dualitet nxjerr në pah presionet me të cilat përballen gazetarët për të përshtatur produktin e punës së tyre sipas interesave dhe kufizimeve specifike të punëdhënësve të tyre në media.

Gratë gazetarë në Shqipëri shpesh përballen me diskriminim sistematik gjinor të rrënjosur thellë në organet e medias.¹²⁴ Edhe pse përbëjnë shumicën e profesionistëve të medias, gratë mbeten dukshëm të nën-përfaqësuar në rolet drejtuese dhe vendimmarrëse. Monitori i Pluralizmit në Media 2024 e konsideroi barazinë gjinore në media si me "rrezik të lartë (81%)" - një vlerësim i detyruar nga përfaqësimi dhe pjesëmarrja e kufizuar e grave në pozicionet drejtuese në media, mungesa e politikave editoriale për barazinë gjinore dhe vazhdimësia e stereotipeve gjinore në vendin e punës.¹²⁵ Raportet tregojnë se burrat dominojnë në mënyrë dërrmuese postet kryesore, si pronësinë, administrimin, drejtimin dhe redaksitë, duke kufizuar kështu ndikimin e grave në vendimet editoriale, barazinë në paga dhe praktikën e sigurisë. Një gazetarë u shpreh: *"Shumica e kryeredaktorëve në redaksi janë meshkuj"*, duke nxjerrë në pah se ata *"nuk i kuptojnë dhe nuk i pranojnë problemet që prekin vetëm gratë"*, gjë që kontribuon në përkeqësimin e mëtejshëm të problemeve që hasin gratë në mjediset profesionale.¹²⁶

— 6.6 KUSHTET E PUNËS

Në Shqipëri gratë përbëjnë një pjesë të madhe dhe në fakt shumicën e fuqisë punëtore në gazetari.¹²⁷ Pavarësisht këtij fakti, ato përballen me probleme të mëdha dhe të ndërlikuara me të drejtat e punës. Pabarazia në vendin e punës është e dukshme si në ecurinë për karrierë ashtu edhe në pagë. Gratë mbeten të nën-përfaqësuar në vendimmarrjen editoriale dhe rolet drejtuese, duke reflektuar vazhdimësinë e një

122 Redaktore pjesëmarrëse në diskutimet në fokus grup

123 Pjesëmarrëse në diskutimet në fokus grup

124 Treguesit e nivelit të lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve në Shqipëri [2020](#), [2021](#), [2022](#) dhe [2023](#).

125 Likmeta, B., & Voko, K. (2024). [Monitorimi i pluralizmit të mediave në epokën digjitale: Raporti për Shqipërinë 2024](#). Instituti i Universitetit Evropian. Qendra për Pluralizmin dhe Lirinë e Mediave.

126 Intervistë me gazetarë

127 [Reporterët pa kufi, 2025, Shqipëria](#)

kufiri të fshehur por të pakalueshëm tek mediat e mëdha.¹²⁸ Edhe ato gra që kanë arritur të kapin poste të larta shpesh u është dashur të kapërcejnë paragjykime të shumta në vetë sistemin ku punojnë. Një faktor strukturor që kontribuon në këtë pabarazi është informaliteti i përhapur në praktikat e pagave në media. Pagat shpesh deklarohen vetëm pjesërisht tek autoritetet tatimore, ndërkohë që një pjesë e pagës paguhet me para në dorë.¹²⁹ Deklarimi i paplotë i të ardhurave ndikon seriozisht te përfitimi i kontributeve shoqërore, si leja e lindjes, etj. Probleme të tjera që vijnë nga pagat informale janë mungesa e ditëve pushim, lejet vjetore, orët shtesë të papaguara dhe mbështetja e pamjaftueshme për raportimin nga terreni me pajisjet e nevojshme të sigurisë.

Këto vështirësi përkeqësohen edhe më shumë për gratë që i përkasin pakicave, gazetaret e pavarura dhe ato që punojnë në mediat lokale, në pozicione të nivelit të ulët ose për mediat online. Këto gra përballen me forma të ndryshme diskriminimi për shkak të përkatësisë etnike, statusit të punësimit dhe prejardhjes krahinore. Nga ana tjetër, është raportuar se punëdhënësit nuk i rinovojnë kontratat që skadojnë gjatë shtatzënisë së gazetareve, duke i lënë nënat e reja me mbështetje minimale ose pa asnjë mbështetje për kujdesin ndaj fëmijëve ose pa u lehtësuar orarin e punës, gjë që u vë grave që kanë fëmijë të vegjël një barrë të rëndë.¹³⁰ Po ashtu, në përgjithësi gratë mungojnë në organet vendimmarrëse në redaksi, duke kufizuar kështu aftësinë e tyre për të hartuar politika të posaçme për vendin e punës. Për këto arsye, ndikimet në shëndetin mendor janë të mëdha, ku shumë gazetarë përjetojnë rritje të stresit, ngacmime, dhe ngarkesa të paqëndrueshme pune, shpesh pa akses në mbështetje të mjaftueshme psikologjike.

Presionet e brendshme në redaksi dhe situata e dobët ekonomike me të cilën përballen gratë gazetarë pasqyrojnë probleme më të thella strukturore në mjedisin e mediave në Shqipëri, i cili karakterizohet nga mbrojtje e dobët në punë, niveli i lartë i informalitetit dhe përqendrimi i pronësisë së medias në pak duar. Këta faktorë të gjerë socio-ekonomikë çimentojnë një mjedis mediatik ku zërat e grave marginalizohen ose mbyten vazhdimisht. Gazetarët raportojnë se herë pas here u duhet të heqin dorë ose të shmangin histori që lidhen me korrupsionin, krimin e organizuar ose abuzimet politike për shkak të presioneve që u bëhen dhe nga frika e hakmarrjes. Shumë gazetarë theksojnë se zakonisht punojnë pa kontrata punësimi ose nuk u paguhen kontributet shoqërore, gjë që përkeqëson edhe më shumë situatën e tyre të dobët. Një gazetarë evidentoi informalitetin e këtij sistemi në këtë mënyrë: *"Nuk kam pasur kurrë një kontratë pune dhe paga shpesh deklarohej pjesërisht ose nuk deklarohej fare te tatimet, gjë që ndikon drejtpërsëdrejti në ndjenjën e sigurisë."*¹³¹ Një tjetër gazetarë e përforcoi këtë pasiguri duke thënë: *"Shumica e mediave i shmangin kontratat dhe detyrimet e sigurimeve*

128 Komiteti Shqiptar i Helsinkit. (2024). [Barometri Kombëtar i Lirisë së Medias në Shqipëri 2022-2023](#). f. 11

129 Treguesit e nivelit të lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve në Shqipëri [2020](#), [2021](#), [2022](#) dhe [2023](#).

130 Pjesëmarrëse në diskutimet në fokus grup

131 Intervistë me gazetarë

*shoqërore, duke na lënë ekonomikisht të pasigurt, veçanërisht kur mbulojnë tema të ndjeshme ose të rrezikshme."*¹³²

Si pasojë, publikut i fshihet informacioni i rëndësishëm që ka të bëjë me qeverisjen dhe llogaridhënien, gjë që dëmton transparencën në demokraci. Gratë gazetare, në veçanti, përballen me rritje të presioneve, duke qenë se përgjithësisht janë ato shënjestër e sulmeve personale që shfrytëzojnë paragjykimet gjinore dhe shoqërore. Ky përkeqësim i situatës së tyre shpesh i çon gratë gazetare edhe më shumë drejt vetë-censurës, duke kufizuar kështu pjesëmarrjen e tyre në gazetarinë investigative dhe debatet publike.

Deri në njoftimin publik të krijimit të Sindikatës së Gazetarëve dhe Punonjësve të Medias (SGPM) në nëntor 2024¹³³, Shqipëria ishte i vetmi vend në rajon pa një sindikatë gazetarësh. Mungesa e një sindikate të tillë bënte që gazetarët të ishin të pambrojtur ndaj presioneve nga politikëtorët editoriale, interesat ekonomike të pronarëve të mediave dhe nga aktorët me influencë politike dhe institucionale. Gratë gazetare janë më në disavantazh nga kjo mungesë, gjë që i privon nga mekanizmat zyrtarë për trajtimin e stereotipeve, për mangësitë në zbatimin e kodit të punës, për paragjykimet gjinore dhe ato shoqërore.

I regjistruar zyrtarisht në shkurt 2024 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë, SGPM synon të përmirësojë të drejtat e punës, të sigurojë paga më të mira dhe të negociojë marrëveshje kolektive me punëdhënësit e mediave, duke aspiruar të krijojë degë sindikale të të gjitha mediave. Edhe pse krijimi i SGPM përfaqëson një moment të rëndësishëm për të drejtat e gazetarëve në Shqipëri, efektiviteti i tij do të varet përfundimisht nga përfshirja, përkushtimi dhe aftësia e tij për të ofruar përmirësime të prekshme për anëtarët e tij.

132 Intervistë me gazetare

133 Shih [SGMP](#)

VII Përfundime

KONTEKSTI DHE OBJEKTI I STUDIMIT

Siguria e gazetareve në Shqipëri mbetet një problem serioz që prek drejtpërsëdrejti gratë në media me implikime të qarta për lirinë e medias, barazinë gjinore dhe, në përgjithësi, për integritetin e demokracisë në vend. Trajtimi i dobësive të tyre nuk është vetëm çështje e mbrojtjes së individëve; kjo gjë ndikon seriozisht në cilësinë e gazetarisë dhe informacionit, në përfshirjen në debatin publik dhe përgjithësisht në forcën e demokracisë në Shqipëri.

PËRMBLEDHJEVE E GJETJEVE KRYESORE

Siguria e grave gazetare në Shqipëri karakterizohet nga forma të vazhdueshme, ndonëse shpesh të kamufluara, të presionit, kanosjeve dhe kërcënimeve, përfshirë ngacmimet online dhe sulmet verbale. Edhe pse kërcënimet dhe rreziqet serioze fizike për jetën janë të rralla, klima mbizotëruese e frikësimit, kushteve të pasigurta të punës, abuzimit online dhe fushatave të shpifjes kufizon ndjeshëm lirinë e grave gazetare, karrierën profesionale dhe pjesëmarrjen e tyre në hapësirën publike. Këto sfida, ndonëse jo gjithmonë të dhunshme, krijojnë një atmosferë të gjithanshme frikësimi dhe vetë-censure.

Gratë gazetare në Shqipëri përballen kryesisht me ngacmimet online, abuzim verbal, kanosje, presione nga aktorë të fuqishëm dhe fushata shpifjesh. Edhe pse rastet e dhunës fizike dhe kërcënimet e drejtpërdrejta për jetën janë serioze, ato janë relativisht të rralla krahasuar me kërcënimet dhe kanosjet e përhapura online që përjetojnë prej tyre. Ngacmimi me padi ligjore, veçanërisht paditë për shpifje, evidentohen shpesh si mjet për të frikësuar gazetarët investigativë dhe për të heshtur gazetarinë kritike.

Pavarësisht kuadrit të konsoliduar ligjor dhe angazhimeve të Shqipërisë sipas standardeve ndërkombëtare, vazhdojnë të ketë mangësi të konsiderueshme lidhur me mbrojtjen e posaçme për gratë gazetare. Ligjet ekzistuese për barazinë gjinore, dhunën në familje dhe diskriminimin nuk arrijnë të trajtojnë kërcënimet digjitale dhe dhunën specifike gjinore që përjetojnë gratë gazetare. Reagimet e

institucioneve ndaj këtyre problemeve janë të fragmentuara, u mungojnë protokollet e qarta, mekanizmat e specializuar dhe koordinimi efektiv mes agjencive të zbatimit të ligjit, sistemit gjyqësor dhe mediave dhe shoqërisë civile.

Ajo që është me e rëndësishmja, gratë gazetare punojnë shpesh në kushte të pasigurta dhe me kontrata informale pune, shoqëruar nga paga të deklaruar pjesërisht ose të padeklaruara të tatimet dhe mungesa të përfitimeve të kontributeve shoqërore. Kjo pasiguri ekonomike e përkeqëson edhe më shumë situatën e tyre të dobët, duke i lënë ato më të cënueshme ndaj presioneve dhe vetë-censurës. Intervistat nxorën në pah se paqëndrueshmëria e vendit të punës dhe pasiguria ekonomike i dekurajojnë shumë gra të merren me raportime investigative ose me tematikë të ndjeshme nga frika e humbjes së punës dhe vështirësive financiare.

Gazetaret raportojnë se përballen vazhdimisht me presione të mëdha që vijnë nga vetë media ku punojnë, presione që shpesh nxiten nga interesa politike ose biznesi të lidhura me pronarët e medias. Gratë gazetare dekurajohen fshehtëzi ose haptazi të mos mbulojnë tema të ndjeshme, duke çuar në fshehjen e historive ose heqjen e tyre në heshtje nga publikimi pa dhënë shpjegime. Dobësia ekonomike përforcon vetë-censurën, duke qenë se gazetarët kanë frikë nga pasojat ose se mos pushohen nga puna nëse u vihen përballë interesa të fuqishme. Gratë gazetare përjetojnë diskriminim gjinor sistematik në mediat shqiptare, gjë që reflektohet në numrin e ulët të tyre në nivelet vendimmarrëse dhe editoriale.

GJITHËPËRFSHIRJA DHE PABARAZITË STRUKTURE

Gratë gazetare që mbulojnë tema me rrezik të lartë, siç janë krimi i organizuar, korrupsioni, politika ose të drejtat e njeriut, bëhen më shumë objekt sulmi, pavarësisht madhësisë ose shtrirjes së medias për të cilën punojnë. Ato që janë më shumë të pranishme në mediat sociale, që punojnë si të pavarura ose që punojnë në media më të vogla dhe të pavarura përballen me vështirësi nga më të ndryshmet, dhe hasin mungesa në burime dhe mbështetje institucionale të nevojshme për mbrojtjen e duhur. Dobësitë për gjithëpërfshirje, siç janë pasiguria ekonomike, marginalizimi gjeografik dhe mungesa e mbështetjes nga media, i intensifikojnë më tej këto rreziqe, duke i lënë shumë gra gazetare të izoluar dhe tejet të ekspozuara ndaj ngacmimeve dhe kanosjeve.

REAGIMET INSTITUCIONALE DHE ORGANIZATIVE

Pavarësisht disa përmirësimeve, siç është miratimi i protokolleve nga agjencitë e zbatimit të ligjit dhe caktimi i personave të kontaktit për mediat, si dhe angazhimeve institucionale për të përmirësuar sigurinë e gazetarëve në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE, mbeten ende mangësi të mëdha për t'u trajtuar. Agjencitë e zbatimit të ligjit vazhdojnë të përballen me vështirësi procedurale dhe praktike në trajtimin me efikasitet të kërcënimeve online, siç janë vështirësitë për marrjen në

kohë të provave digjitale nga platformat online. Prokurorët pranojnë kapacitetet e kufizuara dhe një ngarkesë të madhe çështjesh që vonojnë përgjigjen e duhur dhe në kohë. Përveç kësaj, shpesh vetë mediave si dhe shoqatave profesionale të gazetarëve dhe sindikatës së tyre u mungojnë mekanizmat e posaçëm mbështetës, gjë që bën që ndihma e ofruar prej tyre të jetë e kufizuar ose kryesisht në formë deklaratah, ndërkohë shumë pak prej tyre ofrojnë ndihmë konkrete ligjore, psikologjike ose financiare për gazetaret e prekura.

IMPLIKIMET E GJETJEVE NË PËRGJITHËSI

Këto dobësi strukturore dhe mangësitë e vazhdueshme institucionale kanë pasoja serioze për gazetarinë cilësore, integritetin e informacionit dhe vetë demokracinë. Vetë-censura, e shtyrë nga kërcënimet dhe presionet, sjell si rezultat mosraportimin e historive kritike, duke dëmtuar rëndë rolin mbikëqyrës të medias. Nga ana tjetër, kultura e pandëshkueshmërisë që mbizotëron në vend, e përforcuar nga stereotipet e rrënjosura gjinore dhe normalizimi i ngacmimeve dhe kanosjeve ndaj grave, rrezikon rolet e gazetareve në media, duke ndikuar veçanërisht në kapacitetet e tyre vendimmarrëse dhe pjesëmarrjen në hapësirën publike.

VIII Rekomandime

— A. REKOMANDIME PËR AUTORITETET PUBLIKE

- **Të harmonizohet kuadri ligjor dhe rregullator kombëtar shqiptar për sigurinë e gazetarëve**, mbrojtjen nga paditë abuzive (SLAPP) dhe dhunën me bazë gjinore me direktivat përkatëse të BE-së si dhe të sigurohet zbatimi rigoroz i detyrimeve sipas Konventës së Stambollit të Këshillit të Evropës, rekomandimeve përkatëse të GREVIO-s dhe Konventës së Budapestit për krimin kibernetik.
- **Të ndryshohet Kodi Penal** për të klasifikuar dhunën ndaj gazetarëve dhe gazetarëve si kundërvajtje penale. Në mënyrë të veçantë:
 - Të futet dhuna psikologjike si një nen i veçantë në Kodin Penal, e shkëputur nga dhuna në familje, për të siguruar zbatueshmëri dhe mbrojtje më të mirë.
 - Të njihen gazetarët si nëpunës të shërbimit publik në Kodin Penal, në mënyrë që ata të përfitojnë nga nenet 237 (Goditjet për shkak të detyrës) dhe 238 (Kanosja për shkak të detyrës) të këtij kodi.
 - Të ndryshohet Neni 121/a (Përndjekja) për të përfshirë në mënyrë të qartë përndjekjen e kryer përmes mjeteve teknologjike ose të prezantohet një vepër penale e veçantë që adreson posaçërisht përndjekjen online. Po ashtu, të ndryshohet Neni 108/a (Ngacmimi seksual) për të përfshirë qartë ngacmimin përmes platformave teknologjike ose internetit, ose si alternativë, të futet një dispozitë e posaçme që adreson në mënyrë të qartë ngacmimin seksual online. Përveç kësaj, të njihen në mënyrë të qartë gazetarët dhe mbikëqyrësit publikë si kategori të veçanta që kanë të drejtë për mbrojtje më të mirë sipas këtyre dispozitave.
 - Të forcohen kapacitetet institucionale për të siguruar zbatimin me shpejtësi dhe profesionalizëm të ligjit dhe

për të trajtuar profesionalisht rastet e dhunës fizike dhe digjitale ndaj grave gazetare.

- **Të monitorohet respektimi i Kodit të Punës** në mediat private dhe të publikohen përditësime tremujore lidhur me gjetjet e këtyre monitorimeve me qëllim krijimin e besimit dhe forcimin e rolit të gazetarëve në vend.
- **Të vihen plotësisht në punë dhe të mbështeten mekanizmat ekzistues mbrojtës:** Të sigurohet zbatimi efektiv dhe funksionimi i qëndrueshëm i Qarkores së Prokurorit të Përgjithshëm për Sigurinë e Gazetarëve dhe i Protokollit të Policisë së Shtetit për Sigurinë e Gazetarëve të miratuar kohët e fundit; të sigurohen fonde të posaçme buxhetore, të caktohet personel i specializuar (përfshirë gra oficere dhe mbështetje psikologjike) dhe të krijohen mekanizmat e duhur për trajnim të specializuar të vazhdueshëm, për monitorim, vlerësim dhe raportim të rregullt publik.
- **Të përmirësohen kapacitetet dhe përgjigja institucionale:** Të forcohen burimet dhe kapacitetet e institucioneve kryesore, veçanërisht Departamentit të Krimit Kibernetik, për të siguruar reagim të shpejtë ndaj kërcënimeve digjitale me të cilat përballen gratë gazetare; të hartohen procedura për ndarjen e përsheptuara të të dhënave mes platformave online dhe agjencive të zbatimit të ligjit, me kritere të përcaktuara qartë për prioritizimin e rasteve që lidhen me gazetarët dhe të trajtohen dobësitë specifike të grave gazetare.
- **Të përmirësohet trajtimi gjyqësor i çështjeve që lidhen me median:** Të sigurohet trajnimi i vazhdueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët lidhur me standardet ndërkombëtare për sigurinë e gazetarëve, lirinë e medias, lirinë e shprehjes dhe procedurat gjyqësore me ndjeshmëri gjinore; të integrohen parimet anti-SLAPP në legjislacionin kombëtar duke ndryshuar Kodin e Procedurës Civile dhe Kodin e Procedurës Penale në përputhje me standardet evropiane, përfshirë këtu Direktivën Anti-SLAPP të BE-së dhe Rekomandimin Anti-SLAPP të Këshillit të Evropës.
- **Të standardizohet dhe përmirësohet mbledhja e të dhënave:** Të krijohet një mekanizëm kombëtar i standardizuar për mbledhjen sistematike të të dhënave dhe raportimin e rregullt në publik për dhunën ndaj gazetarëve, të ndara sipas gjinisë, formës së kërcënimit, autorit të agresionit, përgjigjeve institucionale dhe rezultateve të proceseve gjyqësore.
- **Të rriten kapacitetet dhe mbështetja për Komisionerin për Mbrojtjen Kundër Diskriminimit për të** caktuar një person kontakti për hetimet e rasteve të grave gazetare dhe për të bërë të mundur procese të shpejta dhe efikase për investigimet.

— B. REKOMANDIME PËR MEDIAT

- **Të forcohen praktikat e brendshme dhe siguria në vendin e punës:** Të sigurohet zbatimi i plotë i Kodit të Punës duke siguruar kontrata të rregullta pune, duke i deklaruar saktë pagat dhe duke paguar të gjitha kontributet shoqërore e shëndetësore; të kryhen inspektime të rregullta në vendin e punës për të verifikuar zbatimin e kodit dhe transparencën.
- **Të miratohen politika të qarta editoriale në mbrojtje të pavarësisë së gazetarëve:** Të miratohen politika të forta editoriale që mbrojnë pa ekuivok gazetarët nga censura e brendshme, nga ndërhyrjet e jashtme të politikës dhe biznesit, si dhe nga diskriminimi ose ngacmimi me bazë gjinore; të hartohen protokolle sigurie me ndjeshmëri gjinore dhe të krijohen mekanizma efikasë raportimi në redaksi.
- **Të promovohet barazia dhe përfaqësimi gjinor:** Të zbatohen masa të posaçme për rritjen e përfaqësimit të grave në poste drejtuese dhe vendimmarrëse në organet e mediave; të sigurohet ndarja e barabartë e detyrave të raportimit dhe të luftohen vazhdimisht stereotipet gjinore që kufizojnë rolet dhe suksesin e grave në media.

— C. REKOMANDIME PËR SHOQATAT DHE SINDIKATËN E GAZETARËVE

- **Të forcohen shoqatat dhe sindikata:** Të krijohen shoqatave profesionale dhe sindikata gazetarësh më të forta, të pavarura dhe të pajisura mirë, të afta për të ofruar ndihmë konkrete dhe praktike, përfshirë këtu mbështetjen ligjore, psikologjike, emocionale dhe financiare për gazetarët që përballen me kërcënime ose ngacmime.
- **Të shtrihet mbështetja për gazetarëve përtej deklaratave:** Edhe pse deklaratat dhe njoftimet publike janë me rëndësi dhe të dobishme, shoqatat e gazetarëve duhet të krijojnë mekanizma të posaçëm për të ofruar ndihmë konkrete për gratë gazetare që përballen me ngacmime, kërcënime apo kanosje, përfshirë asistencë dhe përfaqësim ligjor, këshillime dhe nisma solidariteti profesional.
- **Të punohet për të mbrojtur më mirë të drejtat në punë:** të punohet fort dhe të lobohet vazhdimisht për përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e sigurisë ekonomike, transparencën e kontratave dhe zbatim më të fortë të ligjeve kundër diskriminimit, duke mbështetur veçanërisht gazetarët e pavarur, ata me kontrata të pasigurta pune dhe gazetarët që raportojnë për tema të ndjeshme.

— D. REKOMANDIME PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

- **Të rriten kapacitetet dhe njohuritë informatike për sigurinë kibernetike:** Të hartohen programe të rregullta trajnimi dhe të caktohen burimet e duhura me fokus të veçantë gratë gazetare për të përmirësuar aftësitë e tyre për sigurinë kibernetike, njohuritë informatike dhe aftësinë për të njohur, parandaluar dhe reaguar në mënyrë efektive ndaj kërcënimeve dhe ngacmimeve online.
- **Të rritet ndërgjegjësimi dhe të mundësohet raportimi:** Të ndërmerren fushata kombëtare ndërgjegjëse për të nxjerrë në pah rreziqet me të cilat përballen gratë gazetare dhe të promovohet kultura e tolerancës zero ndaj ngacmimeve dhe dhunës; të ofrohen udhëzime të qarta dhe burime të posaçme për gazetarët lidhur me mekanizmat institucionalë në dispozicion për raportimin e kërcënimeve ose kërkimin e mbështetjes.
- **Të bëhen hulumtime dhe të monitorohet progresi në mënyrë sistematike:** Të kryhen dhe të publikohen rregullisht raporte kërkimore dhe analitike ku vlerësohet efektiviteti i përgjigjeve institucionale, hartimi i politikave dhe klima e përgjithshme e sigurisë për gazetarët; të përdoren gjetjet e këtyre raporteve si instrumente pune për të lobuar dhe mundësuar përmirësime të qëndrueshme.
- **Të krijohen qasje mbështetëse gjithëpërfshirëse:** Të hartohen masa mbrojtëse dhe programe ndihme që trajtojnë dobësitë në drejtim të gjithëpërfshirjes, me vëmendje të veçantë për nevojat e gazetarëve të pavarur, atyre që punojnë në media të pavarura ose lokale dhe atyre që u përkasin grupeve të marginalizuara apo që vijnë nga zonat rurale.

Titulli në origjinal
Women Journalists' Safety: Albania Report 2024

Autor
Blerjana Bino

Puna në terren
Ina Allkanjari

Kontribuan
Orkidea Xhaferaj, Iris Shehaj

Redaktor
Neda Chalovska Dimovska

Përkthyer nga
Durim Tabaku

Botues
Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt (Safe Journalists Network)
Tiranë, 2025



Cover photo
Andrija Vukelić

Design
comma.rs



Ky botim u bë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e autores dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe opinionet e Bashkimit Evropian.